



Republika e Kosovës
Republika Kosovo-Republic of Kosovo
Kuvendi - Skupština - Assembly

T R A N S K R I P T

NGA MBLEDHJA PLENARE E KUVENDIT TË REPUBLIKËS SË KOSOVËS, TË
MBAJTUR MË 21.10.2011

SA PLENARNE SEDNICE SKUPŠTINE REPUBLIKE KOSOVA, ODRŽANE
21.10.2011. GODINE

TETOR-OKTOBAR
2011

E premte, më 21.10. 2011, ora 10:00

Drejtton seancën: Kryetari i Kuvendit të Kosovës, zoti Jakup Krasniqi

KRYETARI: Të nderuar deputetë,
I nderuari kryeministër, zëvendëskryeministër,
Ministra të Kabinetit qeveritar,
I hap punimet e mbledhjes plenare të Kuvendit të Republikës së Kosovës.

Fillojmë me pikën e parë të rendit të ditës:

1. Koha për deklarime jashtë rendit mëditës

Koha për diskutime jashtë rendit të ditës është e kufizuar në 30 minuta. Diskutimet në emër të grupit janë 5 minuta, ndërsa në emër të deputetit 3 minuta.

Ju e dini që replika nuk ka, po para se të fillojmë ta matim kohën për deputetët, fjalën e ka kërkuar Kryeministri i Qeverisë, zoti Hashim Thaçi, për një informacion për situatën në veri.

HASHIM THAÇI: Ju faleminderit, i nderuar kryetar Krasniqi,
Të nderuar deputetë,
Kabinet qeveritar,
Më lejoni edhe një herë që të përshëndes veprimet e fundit të KFOR-it, EULEX-it, që i bënë në koordinim me institucionet e Republikës së Kosovës, për vendosjen e plotë të rendit dhe ligjit në pjesën veriore të Kosovës.

Operacioni për largimin e barrikadave dhe lirimin e rrugëve në veri është në kuadër të përkushtimeve institucionale të Republikës së Kosovës për të garantuar lirinë e plotë të lëvizjes, vendosjen e rendit dhe të ligjit për të krijuar siguri, paqe, stabilitet, integritet dhe zhvillim të qëndrueshëm ekonomik në pjesën veriore të vendit. Prandaj, ftojme edhe sot qytetarët edhe në pjesën veriore të Kosovës për qetësi, për bashkëpunim të plotë, sepse këto angazhime janë në interes të vet qytetarëve të asaj pjese të territorit të Republikës së Kosovës, në interes të hapjes së perspektivës zhvillimore, jetës së qetë, të sigurt, hapjes së vendeve të reja atë punës dhe rritjes së investimeve të gjithanshme të institucioneve në veri.

Qeveria e Republikës së Kosovës vlerëson lartë përkushtimin e vazhdueshëm të forcave të KFOR-it, të EULEX-it që në kuadër të mandatit të tyre po përmbushin angazhimet për vendosjen e ligjshmërisë dhe të kushtetutshmërisë në pjesën veriore të vendit.

Dëshiroj të theksoj se gjithë angazhimet dhe përkushtimet janë të përbashkëta, të koordinuara në mes të Qeverisë së Republikës së Kosovës, autoriteteve të KFOR-it, EULEX-it, Bashkimit Evropian dhe Shteteve të Bashkuara të Amerikës.

Në emër të Qeverisë së Republikës së Kosovës dënoj edhe një herë dhunën e ushtruar mbi ushtarët e forcës paqeruajtëse të KFOR-it nga ana e pjesëtarëve të strukturave kriminale në veri. Prandaj, dëshiroj të theksoj se edhe sot jemi në angazhimet e përbashkëta, përkushtimet tona do të vazhdojnë për rend, ligj dhe kushtetutshmëri në veri. Jam i bindur se do të kemi sukses. Ju faleminderit!

Drejtimin e seancës e merr zoti Sabri Hamiti, nënkryetar i Kuvendit

KRYESUESI: Ju faleminderit, zoti kryeministër!

Fillojmë me deklaratimet e deputetëve.

Në emër të Grupit Parlamentar të Lidhjes Demokratike, deputeti Anton Quni.

ANTON QUNI: Ju faleminderit, zoti kryesues!

I nderuari kryeministër,

Kabinet qeveritar,

Të nderuar deputetë,

Angazhimi i Policisë së Kosovës, më 25 korrik, për vënie nën kontroll të pikave doganore 1 dhe 31, përveç tjerash pati edhe efektin në ngritjen e besueshmërisë dhe kredibilitetit të Policisë së Kosovës para shumicës së qytetarëve të Kosovës.

Të nesërmen dhe ditëve në vijim, kudo që gjendeshin zyrtarët e policisë pranonin urime, përshëndetje dhe përgëzime nga qytetarët. Aksioni u përkrah pa rezervë nga pjesa më e madhe e spektrit politik dhe shoqërisë civile. U krijua një klimë e solidaritetit maksimal në institucionet e sigurisë, e posaçërisht me Policinë e Kosovës.

U zbehën dhe kaluan në harresë ngjarjet që më herët e kishin komprometuar Policinë e Kosovës, siç ishte, ndër të tjera, zhdukja e provave nga Dhoma e Dëshmimeve, e cila nuk u zbardh deri më sot.

Në ceremoninë e varrimit të heroit Enver Zymberit, me pjesëmarrje masive të popullatës, u nënkuptua se pranë policisë së Kosovës, si institucioni më i respektueshëm dhe si profesioni më fisnik, do të qëndrojë e tërë popullata. Por, edhe kësaj radhe disa ngjarje të mëvonshme, siç janë: arrestimi i disa zyrtarëve të Ministrisë të Punëve të Brendshme dhe të Policisë së Kosovës nga ana e EULEX-it për përvetësime dhe keq menaxhimin e fondeve dhe arrestimi i pjesëtarëve të Policisë së Kosovës për implikimin e tyre në kidnapimin e një qytetari nga Prizreni, janë ngjarje që prapë po e lëkundin besueshmërinë ndaj Policisë së Kosovës, por edhe Ministrisë së Punëve të Brendshme.

Padyshim se në bazë të rasteve të izoluara nuk duhet të krijojmë paragjykime dhe vlerësime për Policinë e Kosovës në përgjithësi. Jemi më se të bindur se në uniformë gjinden djem dhe vajza me nivel të lartë etik, të motivuar për shërbim dhe profesional në detyrë, por as nuk duhet të heshtim para dukurive që e njollosin imazhin e këtij institucioni.

Nga institucioni si përgjegjësi kryesor për luftimin e krimit dhe të krimit të organizuar, të korrupsionit nuk pritet që zyrtarët e saj të jenë pjesëmarrës, nxitës, përkrahës apo jatak të krimit. Ju kujtohet kur Beogradi pati deklaruar se e kanë strategjinë se si të përballen me çështjen e Kosovës dhe të jeni të bindur se pjesë e kësaj strategjie është edhe diskreditimi i institucioneve të sigurisë. Kjo dukuri duhet shikuar dhe studiuar edhe nga ky prizëm.

Po ashtu, edhe ndërhyrja e Policisë së EULEX-it është mesazh se ne nuk jemi ende në gjendje që me forcat tona të luftojmë krimin, përkundër gjithë atyre mekanizmave që i kemi ngritur për anti-korrupsion, auditim, hetimet për krime financiare dhe ekonomike, inspektime e tjera.

Nga aksioni i 25 korrikut ne nxorëm shumë mësim, por një ndër to është se Policia e Kosovës ka mungesë të pajisjeve adekuate, filluar prej helmetave, mjeteve për komunikim të sigurt, mjeteve të vëzhgimit, tarnsporterë, helikopterë e tjera, e tjera. Në një situatë të tillë, t'i keqpërdorësh dhe përvetësosh fondet për ngritjen e kapaciteteve të institucioneve të sigurisë, është krim mbi krimin, sepse nga këto mjete varet siguria e pjesëtarëve të sigurisë së Kosovës, të cilët jo rrallë me jetë e mbrojnë sigurinë e qytetarëve.

Krejt në fund, kërkoj nga kryeministri, nga Ministria e Mbrojtjes, nga Ministria e Punëve të Brendshme, Kabinetit qeveritar të kanë në prioritet të lartë që pa kompromis t'i luftojnë këto dukuri dhe t'i mobilizojmë të gjitha mekanizmat e kontrollit, inspektimit dhe auditimit dhe në mënyrë preventive të mos lejojnë krimin brenda këtij institucioni dhe ta sanksionojnë që në fillimin e saj. Me masat e tilla ne i mbrojmë dhe motivojmë të gjithë ata pjesëtarë që punojmë ndershëm dhe me profesionalizëm të lartë dhe i mundësojmë Policisë së Kosovës që me përformancën e saj të jetë pjesë determinuse e zhvillimeve demokratike dhe politike në ...

(Ndërprerje nga regjia)

KRYESUESI: Ju faleminderit, zoti deputet!

Në emër të Lëvizjes “Vetëvendosje”, flet 5 minutat e vet, Liburn Aliu

LIBURN ALIU: Të nderuar deputet,

Fshati Bellanicë është në Komunën e Malishevës dhe banohet nga rreth 350 familje, me rreth 2500 banorë. Bujqësia dhe blegtoria kanë qenë profesioni i popullatës, e cila për gjatë kohëve me atë pak tokë të punueshme ka mbijetuar. Po ashtu, si edhe shumë fshatrat e tjerë, mërgimi ka qenë njëra ndër mundësitë e mbijetesës për popullatën e këtij fshati.

Ajo që po e bën këtë fshat të njohur tani, është autostrada Vërmicë-Merdare, që do të kalojë fare pranë këtij fshati. Autostrada do të duhej të sillte zhvillim, por duke parë shqetësimet e fshatarëve të Bellanicës, si duket nuk do të jetë kështu.

Autostrada është paraparë të kalojë mu në mes të tokave bujqësore, që janë jetike për këta qytetarë të këtij fshati. Rripi i tokës bujqësore që në fakt është një luginë dhe ku janë tokat bujqësore të fshatit, do të zihet nga autostrada. Dhe pak më larg, rreth 200 metra, është terreni i pjerrët kodrinor, i pa shfrytëzueshëm si tokë bujqësore dhe mjaft i përshtatshëm edhe për ndërtimin e trasesë së autostradës. Në lidhje me këtë çështje, bazuar në shqetësimin e qytetarëve të këtij fshati dhe bazuar në parimet e thjeshta në lidhje me mbrojtjen e tokës bujqësore, e cila gjithandej në Kosovë sot është e persekutuar nga Qeveria, do të doja ta bëja një pyetje shumë të thjeshtë. A është marrë parasysh fakti që autostrada po ndërtohet në tokë bujqësore, duke pasur edhe alternativa tjera? A është bërë analizë dhe a është pyetur fshati?

Bazuar në ligj, realizimi i këtij projekti është e domosdoshme të diskutohet me qytetarë. Ata jetojnë aty me shekuj nga bujqësia. Qytetarët, në bazë të asaj çka arritëm të shohim kontakt me ta, ata nuk janë kundër autostradës. Ata thjeshtë duan të mos u zihet toka, duan të kenë mundësi ta punojnë tokën si më parë dhe kërkojnë devijim për 200 metra më tutje dhe kjo kërkesë është jetike për ta. 200 metra më tutje, prapë do të jetë në pronat e tyre dhe ata, ajo është krejtësisht në rregull dhe janë dakord. Pra, duhet ta kemi të qartë se ata nuk janë pyetur për autostradën, edhe pse ligji e parashikon dhe kërkesa e tyre sot për këtë devijim është e drejtë.

Çështje tjetër që e brengos fshatin e që po ashtu lidhjet me autostradën, por që ka një arsye shtesë për shqetësim, është pjesa e tokës në vazhdim të këtij rripi, e që në lokalitet është e njohur si Dubrava. Është kjo tokë bujqësore ku do të jetë njëra nga nyejt e autostradës. Kjo tokë do të ndërtohet, do të ndërtonte në fakt, do të ndërtonte mundësitë e hyrje - daljeve në autostradë pikërisht në këtë vend. Pra, është pjesë e tokës e cila është e kyçur drejtpërdrejt në autostradë dhe këtu do të mund të thuhej që autostrada do t'u sillte zhvillim banorëve.

Toka bujqësore në Dubravë ka mbi 350 hektarë, ka qenë pronë e banorëve të fshatit Bellanicë dhe në vitin 1958, si në shumë vende në rrethinë dhe në tërë Kosovën, kjo tokë fshatarëve u është marrë nga kooperativa, e në këtë rast nga kooperativa "Mirusha". Fshatarët asnjëherë nuk janë pajtuar me këtë rrëmbim të pronës nga pushteti i atëhershëm jugosllav dhe nuk kanë nënshkruar asnjë lloj dakordimi me këtë dhe, përkundrazi, që atëherë kanë bërë ankesat e tyre në gjykata në emër të 114 shtëpive dhe 800 banorëve të fshatit që jetonin në aso kohe.

Për këtë rrëmbim të tokës, ata asnjëherë nuk kanë marrë asnjë lloj kompensimi. Banorët kanë dokumentacion dhe fleta poseduese që dëshmojnë pronësinë e tyre. Shumë nga këto fleta kanë humbur dhe janë djegur gjatë luftës, por ka të tjera që kanë mbetur e që dëshmojnë pronësinë e tyre. Në shumë vende të tjera, pronat e rrëmbyera të qytetarëve në kooperativën "Mirusha" u janë kthyer pronarëve, por kjo nuk ka ndodhur në vendin e quajtur Dubravë, aty ku pra do të jetë nyja e autostradës. Kjo tokë, në vitin 2009 është privatizuar me vlerë 12 euro për ari, e që i bie 1200 euro për hektar, është privatizuar edhe përkundër kontestit gjyqësor që ekziston, pra në kundërshtim me ligjin.

Është privatizuar edhe pa i pyetur banorët, respektivisht pronarët legjitim që jetojnë në fshatin Bellanicë. Sot kjo tokë kushton shumë më shtrenjtë dhe me shitjet e stërshitjet e vazhdueshme, banorët e Bellanicës, pronarët legjitim të tokës që ua rrëmbeu pushteti jugosllav, janë vetëm vëzhgues. Kjo tokë në pjesët që do të zihet nga autostrada, kompensohet me nga 1000 euro për ari e më lart. Është privatizuar 12 dhe kompensohet me mbi 1000, çfarë marifeti i pasurimit në Kosovën e lirë dhe të pavarur! shtet ndërtim i thonë këtij, jo mahi!

Qytetarët, edhe në lidhje me këtë problem kanë bërë petition dhe ky petition tani ka mbërri edhe në Kuvend. Ata duan që pronat e rrëmbyera t'u kthehen, ato prona pra që u janë rrëmbyer nga pushteti jugosllav, e që padrejtësisht janë privatizuar në këtë pushtet dhe kanë të drejtë në kërkesën e tyre. Pra, do të duhej që...

(Ndërkreje nga regjia)

KRYESUESI: Ju faleminderit, zoti deputet!
Fjalën e ka deputeti Shqip Muja.

SHIP MUJA: I nderuar kryesues,
Ne deshëm që në emër të Grupit Parlamentar të Partisë Demokratike t'i inkurajojmë prapë angazhimet dhe t'i dërgojmë falënderimet për angazhimet që është duke bërë KFOR-i në zbërthimin e barrikadave të ndërtuara në kokën e disa ekstremistëve dhe grupeve kriminale në veri dhe njëkohësisht inkurajojmë angazhimin dhe bashkëpunimin e Qeverisë që në këtë drejtim të mos hiqet dorë dhe të jepet edhe më shumë publicitet edhe nga aspekti ndërkombëtar për këtë situatë e cila është në përfundim e sipër dhe një herë e përgjithmonë duke u krijuar kushtet për t'u integruar në strukturat e Republikës së Kosovës edhe ajo pjesë e mbetur e qytetarëve dhe të vazhdojnë në normalitetin përgjithshëm në Kosovë.

Ne dënojmë dhunën e cila është krijuar kundër KFOR-it dhe forcave paqeruajtëse ndërkombëtare atje nga ato grupe të cilat janë të pa pranueshme për Grupin Parlamentar të Partisë Demokratike, por edhe për tërë qytetarët e Republikës së Kosovës dhe mendoj se ajo dhunë duhet të dënohet edhe nga të gjitha grupet dhe të inkurajohen dhe të mbështeten me çdo mjet politik dhe me çdo formë tjetër Forcat paqeruajtëse në Kosovë. Ju faleminderit!

KRYESUESI: Ju faleminderit!
Fjalën e merr deputeti i AAK-së, Daut Haradinaj.

DAUT HARADINAJ: Ju faleminderit, kryesues!
Të nderuar deputetë,

Me 25 korrik, kur ndodhi ndërhyrja e shumëpritur në veri të Kosovës, të gjithë menduam se strukturave paralele po ju vjen fundi, por ndodhi e kundërta. Kosova humbi një polic nga këto banda dhe veriu u betonizua skajshëm në hyrje dhe dalje të kësaj pjese të Kosovës. Na i dhamë mbështetje ndërhyrjes për ta vënë nën kontrollin

institucional pjesën e veriut dhe sot gjendja në këtë pjesë të Kosovës është shumë më e keqe se sa para 25 korrikut.

Veprimet e fundit që po ndërmerr KFOR-i në veri të Kosovës, janë dëshmi e pafuqisë të lidershit tonë. Ne po përballemi me një grup kriminelësh që po tentojnë t'i sfidojnë institucionet e Kosovës dhe aleancën më të fuqishme ushtarake në botë, NATO-n, po përballemi po me ata njerëz të cilët e humbën Kosovën një herë e përgjithmonë në pranverën e vitit '99. Ata duhet ta dinë se populli i Kosovës dhe bashkësia ndërkombëtare janë të vendosur më shumë se kurrë që rendi dhe ligji të mbizotërojnë në tërë Kosovën. Qytetarët e veriut të Kosovës duhet ta dinë se e ardhmja e tyre është në Prishtinë e jo diku tjetër.

Kosova në ditët fundit ka marrë goditje të ashpra edhe me Raportin e Progresit. Nga ky raport shihet qartë që shumica e dukurive negative burojnë pikërisht nga udhëheqja e keqe e institucioneve të Kosovës. Tendenca për ta paraqitur të suksesshëm këtë raport, është fyerje për popullin e Kosovës. Ne si AAK do t'i mbështesim fuqishëm aktet që kanë për obligim kushtetues dhe misionet ndërkombëtare për vënie nën kontroll të pjesës veriore.

Aleanca për Ardhmërinë e Kosovës i jep mbështetje të fuqishme dhe të plotë KFOR-it dhe mekanizmave të tjerë në operacionet e tyre për zhblokimin e rrugëve dhe për vendosjen e rendit dhe ligjit në veri të Kosovës. Do të mundohemi pa rezervë që gjendja e rëndë në Kosovë dhe raportet e ardhshme të jenë pozitive. Si të zgjedhurit e popullit, kemi obligim që qytetarët e Kosovës ta dinë të vërtetën.

Populli i Kosovës pret nga institucionet e veta që ti hapin rrugë integritetit të vendit në strukturat euro-atlantike, gjë që do të ndikonte drejtpërdrejtë...

(Ndërprerje nga regjia)

KRYESUESI: Ia shtoni kohën, në emër të Grupit!

DAUT HARADINAJ: Faleminderit! Pa dyshim që të gjithë qytetarët e Kosovës, spektri politik dhe institucionet duhet të kontribuojnë bashkërisht në tejkalimin e këtyre sfidave. Kosovës i duhet dialog politik i brendshëm dhe jo me ata që koncepte kanë të dështuarën për historinë e kaluar.

Jam i bindur se me angazhimin e përbashkët do t'ju sjellim ditë më të mira qytetarëve të Kosovës, që me të drejtë e kanë humbur durimin nga premtimet e mëdha qeveritare. Ju faleminderit!

KRYESUESI: Ju faleminderit, zoti deputetë!

Në emër të Aleancës Kosova e Re, deputetja Myzejene Selmani.

MYZEJENE SELMANI: Ju faleminderit, zoti nënkryetar!

Përsëritje për kryeministrin, zëvendëskryeministrat, ministrat dhe të gjithë deputetët!

Koalicioni për Kosovë të Re, pikë së pari përshëndet aktin e vendosjes s'rendit dhe të ligjit nga KFOR-i në pjesën veriore të Mitrovicës dhe shpreson shumë që ditët e ardhshme do të jenë ditë të mira për zbatimin e dhe të Kushtetutës në pjesën veriore të Kosovës.

Çështja që do ta ngrejë unë sot, është kjo: Kuvendi i Republikës së Kosovës, në seancën e mbajtur me 7 prill 2011, ka miratuar Rezolutën e cila është mbështetur në memorandumin e marrëveshjes ndërmjet zotit Bexhet Pacolli, zotit Isa Mustafa dhe zotit Hashm Thaçi. Memorandumi i arritur më 6 prill 2011. Kjo marrëveshje ka rëndësi të madhe pasi që ulëte tensionet politike në një situatë të ndërlikuar dhe hapte rrugë për konsolidimin e institucioneve dhe ndryshimet e nevojshme në Kushtetutën dhe sistemin zgjedhor që forcojnë demokracinë dhe shanset për të gjithë.

Në kuadër të marrëveshjes, rezoluta, pika 2, thuhet: “Kuvendi i Republikës së Kosovës mbështet zotimet dhe afatet kohore të përmbajtura në memorandumin që kanë të bëjnë me nevojën për amendamentimin e Kushtetutës së Republikës së Kosovës dhe legjislacionit të ndërlidhur në mënyrë që Presidenti i Republikës së Kosovës të zgjedhet në mënyrë të drejtpërdrejtë nga populli”, mund të shihet edhe në transkript.

Kjo duhet të krijojë një atmosferë demokratike, siç theksuam, me shanse të njëjta për të gjithë shtetasit e Kosovës. E konsiderojmë që vënia e kufizimeve artificiale vetëm për njërën nga funksionet kyçe, nuk është parimore dhe nuk është në frymën e bashkëpunimit dhe marrëveshjen për ndryshime.

Grupi Parlamentar i Koalicionit për Kosovë të Re, zotimet dhe mbështetjen për Rezolutën e fakton duke dhënë kontributin e saj në Komisionin për amendamentimin e Kushtetutës dhe e Ligjit zgjedhor. Ditëve të fundit janë duke u organizuar debate për propozimet e Komisionit për ndryshime kushtetuese. Disa nga çështjet janë bërë pjesë e debatit politik dhe qytetarëve, ndër to është edhe shtetësia për kualifikim për zgjedhjen e presidentit.

Kriteri i shtetësisë për kandidatët është paraqitur në tri opsione. Një ndër këto opsione është që kandidati duhet të jetë shtetas i Kosovës dhe në rast të dyshtetësisë, të heqë dorë nga shtetësia tjetër në momentin e kandidimit apo zgjedhjes. Kjo është bërë tema më e theksuar nga disa anëtarë të Komisionit. Ndoshta këto janë edhe qëndrimet politike të subjekteve të tyre.

Qëndrimi i Grupit Parlamentar të Koalicionit për Kosovë të Re vlerëson se vendosja e kushtit për heqjen dorë nga dy shtetësia për kandidatë në momentin e kandidimit për president, është diskriminuese dhe antikushtetuese për një pjesë të madhe të qytetarëve të Kosovës që kanë dhënë dhe japin kontribut të madh për Kosovën. Nëse kërkohet një gjë e tillë për kandidatët për president, atëherë kjo duhet të vendosej edhe për shumë pozita të larta, si kryeparlamentar, kryeministër, ministër, kryetar i Gjykatë Kushtetuese dhe kryetarë të komunave.

E ngritja këtë çështje pasi që ka një peshë të madhe politike, me ndikim në atmosferën politike të përgjithshme të Kosovës. Ju faleminderit!

KRYESUESI: Ju faleminderit!
Grupi i SLS-së, Sasha Millosavleviq.

SAŠA MILOSAVLJEVIĆ: Hvala, gospodine predsedavajući!
Poštovani premijeru, ministri,
Drage kolege,
Kao što i sami znate, juče je došlo do još jednog napada na Srbe na teritoriji Kosova. U selu Dobruši kod Peći, u napadu je poginuo Miško Komatina, a teško su ranjeni Dejan Bogičević i Darko Ojdanić. SLS izražava duboko saučesće porodici poginilog Miška Komatine i najoštrije osuđuje ovaj napad.

Zahtevamo od Vlade, Policije, EULEX-a i međunarodne zajednice da učine sve kako do ovakvih napada više ne bi došlo i da počinioci budu uhvaćeni i adekvatno budu kažnjeni.

Ovo je za kratko vreme drugo ubistvo Srba i mi kao predstavnici Srba u Skupštini Kosova duboko smo zabrinuti zbog sve učestalijih napada na naše sunarodnike.

U trenucima kada je kriza na severu Kosova sve veća, institucije treba da budu u službi smirivanja tenzija.

I na kraju, hteo bih da dodam da ovakvi napadi mnogo utiču i na povratak Srba na teritoriji Kosova. Hvala!

KRYESUESI: Faleminderit! Fjalën e ka deputetja Afërdita Berisha-Shaqiri.

AFËRDITA BERISHA-SHAQIRI: I nderuar kryesues,
Zoti kryeministër, ministra,
Të nderuar deputetë,
Të nderuar qytetarë,
Një nga problemet dhe preokupimet kryesore të popullatës së Kosovës, e sidomos të të rinjve është pikërisht çështja e papunësisë. Ajo përbën një nga sëmundjet më të rënda të shoqërisë kosovare, e cila kërkon medikament të fortë politik për ta shëruar.

Papunësia është një nga faktorët kryesorë makro-ekonomikë, e cila me normën e saj të ulët bën ekonominë të gjendet në fazën më të mirë të saj – ekspansionin ekonomik ose në të kundërtën, norma e lartë e papunësisë e bën ekonominë të gjendet në gjendjen më të keqe të saj – recesionin ekonomik.

Në Kosovë kemi një gjendje me varfëri dhe shkallë të lartë të papunësisë. Edhe pse në planin qeveritar - Power-point është paraparë krijimi i vendeve të reja të punës, ajo nuk është bërë. Bile, gjatë fushatës elektorale patëm shumë premtime edhe nga partia, e cila është në koalicion, për mija vende të reja pune, prandaj shtroj pyetjen: - Ku janë vendet e

reja të punës që i premtuat dhe a do të mundeni prapë të premtoni edhe në zgjedhjet e ardhshme mijëra vende të reja pune?

Shkalla e papunësisë paraqet apo është treguesi i mirëqenies ekonomike. Sipas të dhënave të fundit, Kosova ka normën e papunësisë 45.4%, ndërsa komunat me shkallë më të lartë të papunësisë janë: Dragashi, Drenasi, Deçani, Klina, Podujeva, Suhareka e të tjera.

Sipas këtyre të dhënave të paraqitura, shtrohet pyetja: Çfarë mirëqenie ekonomike paskan qytetarët tanë? S’do mend, shumë prej tyre atë të kronikave “edhe unë jam Kosovë” apo të atyre që tërë ditën bredhin rrugës për të gjetur një punë ditore.

Krijimi i vendeve të lira të punës duhet të jetë në fokus të krijuesve të politikave dhe të strategjisë së zhvillimit të Kosovës. Krijimi i një rrethine tërheqëse për investimet është më se i nevojshëm me qëllim të zvogëlimit të normës së lartë të papunësisë, si dhe të krijimit të perspektivës së punësimit për gjenerata të reja që hyjnë në tregun e punës.

Qeveria e Kosovës duhet të krijojë strategjinë e zhvillimit dhe politikën përkatëse të punësimit dhe të vlerësojë se në çfarë mase politikat ekonomike ekzistuese janë në përputhshmëri me këtë...

(Ndërprerje nga regjia)

KRYESUESI: Faleminderit, zonja deputete!
Fjalën e ka deputeti Glauk Konjufca!

GLAUK KONJUFCA: Faleminderit!
Instituti Kosovar për Kërkime dhe Zhvillim të Politikave ka publikuar një hulumtim tejet shqetësues për procesin e zgjedhjeve të fundit të përgjithshme në Kosovë.

Instituti vëren se këto zgjedhje kishin shënuar rënie në nivel të organizimit në krahasim me ato të vitit 2007, kurse ka theksuar se kanë dështuar tri hallka institucionale: Policia, Prokuroria dhe gjykatat.

Raporti konkludon se, po citoj në këtë rast: “Ka pasur vjedhje ekstreme të votave dhe manipulim të numrit të votave të shënuara në formularë të numërimit”.

Instituti, po ashtu, argumenton se në këto manipulime dhe vjedhje masive ishin përfshirë së paku 5.000 persona, të cilët duhet të vihen para drejtësisë.
Po ashtu, thuhet se manipuluesit e zgjedhjeve kanë mbetur pothuaj se të pa ndëshkuar.

Sipas raportit, mosndëshkimi i manipuluesve të zgjedhjeve më 2007 ka qenë prej faktorëve kryesor pse është rritur numri i manipulimeve gjatë zgjedhjeve të fundit.

Prej 100 lëndëve të 2007-tës, janë shqyrtuar vetëm 36. Për asnjërën prej tyre nuk është mbajtur proces gjyqësor. Kjo ka bërë që manipulimet të rriten pastaj, prej 500 personave

të akuzuar për zgjedhjet e fundit, vetëm 7 janë dënuar me burgim. Burgimi më i lartë ka qenë vetëm 1 vit, ndërkohë që sipas Kodit Penal mund të ishte deri në 5 vjet.

Sipas kësaj logjike, kështu po investohet në manipulime edhe më të mëdha në zgjedhjet e ardhshme. Prokuroria e shtetit dhe prokuroritë komunale nuk i kanë trajtuar krimet zgjedhore me prioritet, kurse ato pak dënime që janë shqiptuar janë kryesisht me gjoba simbolike prej 250 deri në 1.350 euro.

Ky është një inkurajim i shkëlqyer për hajnat milionerë. Në këtë mënyrë, ata kanë aq para sa për t'i manipuluar dhe blerë të gjitha votat.

Raporti thotë, po e citoj në këtë rast: “Dënimet e pakta dhe të ulëta që u shqiptuan, mund të cilësohen si tarifa për blerjen e votave, rrjedhimisht legalizim i tregtisë me vota”.

Në raport thuhet se manipulimi i madh shton dyshimin nëse disa të zgjedhur vërtet janë drejtpërdrejt si zgjedhje e popullit, apo si rezultat...

(Ndërprerje nga regjia)

KRYESUESI: Dy minuta, llogaritni! Regjia, shtojani edhe një minutë! Jo dy, edhe një minutë e ka!

GLAUK KONJUFCA: Aty ngrihet shqetësimi që këta njerëz në masë të madhe janë rezultat i manipulimeve, nuk e ndjenjë nevojën e të qenit përgjegjës para popullit, përmbi të gjitha para atyre që ua kanë mundësuar zgjedhjen përmes manipulimeve, duke konkluduar se këtu është dëmtuar thelbi i demokracisë, pra llogaridhënia. Kjo pastaj e dekurajon qytetarin për të marrë pjesë në zgjedhje, sepse ai nuk e di se vota e tij ka ndikim dhe se po e sheh që manipuluesit nuk po ndëshkohen.

Ky raport na tregon për legjitimitetin e dyshimtë të pushtetit, kapjen e kontrollit të drejtësisë nga ky pushtet, si dhe dhunimin e demokracisë në funksion të asaj që po ndodh tash për tash, pra me negociatat me Serbinë, si dhe shitjen e pasurive të Kosovës dhe korrupsionin enorm që e ka kapluar pushtetin.

Raportin duhet ta lexojnë të gjithë, sipas mendimit tim, përveç Qeverisë, sepse Qeveria e di përmbajtjen e raportit pa e lexuar hiq.

KRYESUESI: Faleminderit! Deputetja Ganimete Musliu e ka fjalën!

GANIMETE MUSLIU: Faleminderit, zoti kryesues!

I nderuari kryeministër,

Të nderuar ministra,

Të nderuara kolege dhe ju kolegë deputetë,

Të nderuar qytetarë të Kosovës,

Ditëve të fundit është shfaqur një dukuri negative në Kosovë që ka të bëjë me dëmtimin e varrezave dhe memorialëve përkujtimore. Rastet e fundit, që i kemi janë në Vushtrri dhe

në Majac të Podujevës, kur në Vushtrri është konstatuar që fëmijët ishin ata që ngjyrosën fotografitë e martirëve, ndërsa në Majac të Podujevës, persona të panjohur kanë dëmtuar Kompleksin memorial Bedri Bajrami. Andaj, mendoj se këto dy raste, por edhe shumë raste tashmë të njohura në Kosovë, janë të bollshme që të thërrasim ndërgjegjen tonë, që të bëjmë thirrje tek institucionet e Kosovës që në bashkëpunim me institucionet komunale të planifikojnë një vi buxhetore për përkujdesjen që memorialet përkujtimore të kenë trajtimin e merituar institucional sepse, të nderuar deputetë, të nderuar kolegë, duke u përkujdesur për memorialet e martirëve dhe dëshmorëve të kombit, ne me të vërtetë vetëm atëherë përkujdesemi për gurthemelet e shtetit tonë. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Deputetja Teuta Haxhiu!

TEUTA HAXHIU: Faleminderit, i nderuar kryesues i Kuvendit!

I nderuar kryeministër,

I nderuar Kabinet qeveritar,

Të nderuar kolegë deputetë,

Muaji tetor – muaji i luftës kundër kancerit të gjirit. Kanceri i gjirit është jo vetëm një nga sëmundjet që po prek gjithnjë e më shumë vajza e gra të Kosovës, por është një ndër shkaktarët kryesor të vdekjeve ndër to. Dhe jo vetëm që po prek femrën në mënyrë individuale, por sëmundja e kancerit në këtë mënyrë e prek gjithë familjen. Prandaj, shqetësimet lidhur me këtë sëmundje po rriten dita - ditës.

Unë sot ngre zërin që në emër të gjitha grave, pra nënave në Kosovë, kërkoj nga Ministria e Shëndetësisë dhe shteti i Kosovës që të shqyrtojnë më me seriozitet çështjen e kancerit në gj, sidomos ofrimin e shërbimeve falas të mamografisë për të gjitha gratë. Kjo do t'i kontribuonte para se gjithash të ardhmes së fëmijëve tanë dhe të ardhmes sonë të shëndetshme në përgjithësi. Sepse, aty ku dëgjohet zëri i nënës, jeta është më e ëmbël.

Shërimi i çdo sëmundjeje, sidomos kur është në pyetje kanceri në gj, është më i suksesshëm nëse diagnostifikimi dhe trajtimi fillon sa më herët. Prandaj, dhënia e kësaj mundësie grave të Kosovës, mbi të gjitha, do të thotë vetëdijesimi ynë kolektiv dhe obligim ndaj familjes sonë.

Unë jam e vetëdijshme se fillimi i kësaj beteje nuk është i lehtë, mirëpo nuk do të thotë që ne të heqim dorë nga luftimi i saj. Ne do të gjejmë mënyra që gratë e Kosovës të kenë mundësi që së paku t'iu ofrohet nga Ministria e Shëndetësisë incizimi i gjirit me rreze rëntgen apo mamografia. Unë, me sa jam në dijeni, në shtetet skandinave kjo është edhe obligim.

Prandaj, më lejoni t'i përmend, krejt në fund, disa shifra alarmante mbi kancerin në gj. Në botë çdo vit preken nga kanceri i gjirit 1.5 milionë gra. Në SHBA, çdo 3 minuta zbulohet një sëmundje me kancer në gj nga mamografia, ndërsa çdo 13 minuta vdes nga një femër me këtë sëmundje. Në Evropë, nga kjo sëmundje sëmuret çdo e 10-ta femër, apo 250.000. Prej tyre, çdo vit vdesin 70.000 gra. Nga kanceri në gj në vendet e rajonit, sidomos sipas statistikave, sëmuret çdo e 9-ta apo e 11-ta femër. Fatkeqësisht, nuk kemi

të dhëna të sakta, që ky numër konsiderohet edhe në vendin tonë. Mirëpo, bazuar në këto fakte, mund të llogaritet se situata është e njëjtë, pra mos të themi edhe alarmante.

Prandaj, duke u bazuar në këtë vështrim, krejt në fund, do të përfitoj sot nga prania e vendimmarrësve në këtë Kuvend që kjo kërkesë urgjente e grave të Kosovës dhe femrës sonë të fillojë së zbatuari në afatin sa më të shkurtër. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit, zonja deputete!

E harxhuam kohën e paraparë për deklarime për çështje që nuk janë në rendin e ditës.

Kalojmë në pikën:

2. Koha për pyetje parlamentare

Deputeti Lutfi Haziri, pyetje për kryeministrin Hashim Thaçi. Deputeti s'është këtu, kryeministri është këtu.

Deputeti Lutfi Haziri, pyetje për ministrin Krasniqi. Prapë, Lutfiu s'qenka këtu, ministri është këtu.

Deputeti Xhevdet Neziraj, pyetje për ministrin Radojica Tomiq.

XHEVDET NEZIRAJ: Kam marrë përgjigje, kështu që nuk do të bëj pyetjen!

KRYESUESI: Faleminderit, zoti deputet!

Deputeti Liburn Aliu, pyetje për ministrin Blerand Stavileci!

LIBURN ALIU: Unë pyetjen edhe herën e kaluar kam dashur ta bëj, po zoti ministër nuk ka qenë. Pra, nuk është as sot. Ndërsa, unë do të vazhdoj ta lexoj pyetjen, pasi që qe dy hera që po shkojnë, unë duhet së paku ta bëj pyetjen që të jetë publike dhe t'i jap disa të dhëna që i kam këtu.

Pyetja ime ka të bëjë me pagesat direkte për blegtori, sipas premtimeve të dhëna. Nga të dhënat që janë, sipas buxhetit për vitin 2011, subvencione dhe transfere janë paraparë 3.800.000 euro. Për shtazët e imta, vitin e kaluar janë paguar nga 10 euro për copë, dhe premtimi ka qenë edhe këtë vit që të bëhet nga 10 për copë. Deri tani është bërë nga 5 euro për copë, që i bie, për 120.000 shtazë të vogla, dhi e dele, të jenë paguar 600.000 euro. Dhe kur kësaj vlere ia shtojmë edhe 3.200.000 euro, që janë paguar për tokat e mbjella me grurë, i bie që është shpenzuar buxheti për sa i përket subvencioneve dhe transfereve. Pra, kanë mbetur pa paguar edhe gjysma tjetër për shtazë të imta - dhi e dele, e po ashtu kanë mbetur të pa paguara subvencionet për lopët nëpër ferma, e që i bie: nëse e shikojmë çmimin qysh është paguar në vitin e kaluar në 30 euro, e që janë rreth 35.600 lopë të paraqitura, të regjistruara për subvencion, i bie që do të jenë edhe 1 milionë euro të tjera, dhe gjysma e pagesës për shtazë të imta, i bie që janë edhe 1.600.000 euro.

Në anën tjetër, buxheti është shpenzuar. Kisha dashur të bëjë pyetje se a do të realizohet pagesa e plotë për blegtorët sipas premtimit për delet, dhitë dhe lopët dhe, nëse do të realizohet, kjo pagesë kur do të bëhet, kur do të jetë realizimi i kësaj pagese? Kjo ishte pyetja ime, shpresoj se ndonjëherë, në ndonjë të ardhme do ta marrim përgjigjen!

KRYESUESI: Faleminderit, zoti deputet! Deputetja Donika Kadaj-Bujupi, pyetje për kryeministrin Thaçi. As s'është deputetja, as s'është kryeministri!

Prapë, deputetja Donika Kadaj-Bujupi, pyetje për zëvendëskryeministren Mimoiza Kusari-Lila! As s'është Donika, as s'është Lila!

(Reagime)

Donika s'është, por është Lila qenka këtu! Kërkoj falje! Po, pra, ministrja është këtu!

Deputeti Shaip Muja, pyetje për ministrin Dardan Gashi! Shaip, urdhëro, a do të bësh pyetjen?

SHAIP MUJA: Do t'ia bëj pyetjen, zoti kryesues, sepse ndoshta nuk vjen edhe herën e ardhshme, po sekretaria mund t'ia çojë kërkesën ministrit Gashi. Çështja qëndron për zotin ministër. Qe disa herë ne kemi ngritur problemin e dëmtimit të ambientit nga ana e disa kompanive që operojnë në Republikën e Kosovës, siç është kompania "Ferronikeli", "Sharçemi", "Elektroekonomia e Kosovës" e të tjera dhe ka mbi 3 herë, dhe së fundi në Ligjin për diversitetin janë ngritur këto shqetësime në mënyrë shumë serioze, ku këta kontaminues të mëdhenj janë të papranueshëm me veprimet e veta.

Ne i kemi propozuar disa veprime praktike dhe konkrete që të ndërmerren, edhe pse është deklaruar nganjëherë në media nga ana e ministrit se nuk kemi kapacitete të mjaftueshme për të menaxhuar këto çështje praktike që janë duke u manifestuar pa pengesë nga asnjë institucion, përfshirë edhe nga institucioni i Ministrisë së Ambientit, ose me pengesa shumë sipërfaqësore.

Pyetja është se kur ka qenë lajmërimi i parë i "Ferronikelit", i "Sharçemit" dhe këtyre kompanive për shkeljet që janë duke u bërë dhe ligjeve që janë në fuqi për ruajtjen e ambientit dhe cilat janë hapat që janë ndërmarrë dhe stafi juaj sa i ka marrë seriozisht propozimet e shqetësimeve të deputetëve të Republikës së Kosovës dhe shqetësimet e votuesve të Republikës së Kosovës?

Kjo ishte pyetja për zotin ministër! Besoj se do ta marrim përgjigjen në seancën e radhës nga ministri ose nga dikush që është përfaqësues apo kompetent që mund ta përfaqësojë. Faleminderit!

KRYESUESI: Prapë, deputeti Shaip Muja, pyetje për zëvendëskryeministrin Hajredin Kuçi, që s'është këtu. A do ta bësh pyetjen?

SHAIP MUJA: Prapë lidhet kjo me çështjen e “Ferronikelit” dhe meqë është “Ferronikeli” një recidiv shkelës, edhe “Sharcemi” e kompanitë tjera, mendoj që gjobat që janë duke u dhënë në kundërvajtje, ato kalojnë në çështje penale dhe desha qartësim juridik se një shkelës recidiv i ligjit a hyn në dënime kundërvajtëse apo klasifikohet si vepër penale që të interpretohet nga aspekti juridik. Faleminderit, shumë!

KRYESUESI: Faleminderit, zoti deputet!

Deputeti Visar Ymeri, pyetje për ministrin Bedri Hamza! Visar Ymeri, me kartelën e Albana Fetoshit!

VISAR YMERY: Faleminderit, kryesues!

Në programin e Qeverisë tuaj, zoti ministër, sikur të kësaj, po edhe të Qeverisë Thaçi I, në masë të madhe i është kushtuar një rëndësi e veçantë afirmimit ndërkombëtar të Kosovës. Pra, pyetja ime ka të bëjë drejtpërsëdrejti me punën tuaj, e që është e ndërlidhur, po ashtu edhe me marrëdhëniet që Kosova i ka me jashtë.

Pra, deri tash Kosova është anëtarësuar në dy institucione ndërkombëtare financiare. Siç e dimë, pra, është në Bankën Botërore dhe FMN. Po, natyrisht që ka edhe institucione tjera financiare mbi kombëtare, ndihma nga të cilat kishte për të qenë e mirëseardhur në shumë projekte të nevojshme për Kosovën, siç e dimë të gjithë. Pra, ne jemi të vetëdijshëm që jemi duke shpenzuar një shumë goxha të konsiderueshme të buxhetit për investime në infrastrukturë, nganjëherë dhe shpeshherë, duke lënë anash sektorë shumë të rëndësishëm të ekonomisë dhe të industrisë për shkak të mungesës së fondeve.

Pyetja ime ka të bëjë me Bankën Evropiane për Rindërtim dhe Zhvillim. A keni aplikuar si Qeveri dhe si Ministri për t’u anëtarësuar në këtë bankë?

KRYESUESI: Zoti ministër!

MINISTRI BEDRI HAMZA: I nderuar, nënkryetar i Kuvendit,

E nderuar zëvendëskryeministre, ministra të nderuar,

Deputetë të nderuar,

Zoti Ymeri, faleminderit për pyetjen!

Siç e theksuat edhe ju, në pyetjen tuaj, Kosova tash veç është anëtare e Fondit Monetar Ndërkombëtar dhe Bankës Botërore.

Megjithatë, ka edhe zhvillime tjera pozitive në këtë fushë dhe ndër të tjera kanë hyrë në fazën e negocimit edhe 20 marrëveshje për ndihmën reciproke në çështje doganore, ndër këto 6 marrëveshje tash veç janë në fuqi. Për më tepër, Dogana e Kosovës është edhe në proces të anëtarësimit në Organizatën Botërore të Doganave dhe, si rezultat i punës, presim që gjatë muajve të ardhshëm të jemi anëtar i kësaj organizate. Janë nënshkruar edhe disa marrëveshje me disa shtete shumë të rëndësishme dhe janë në proces të nënshkrimit edhe marrëveshje tjera për eliminimin e tatimeve të dyfishta.

Sa i përket anëtarësimit në IBRD, është një institucion mjaft i rëndësishëm për zhvillimin ekonomik të Kosovës, kërkohen disa parakushte. Parakusht i parë është që vendi të jetë

anëtar i Fondit Monetar Ndërkombëtar, që është plotësuar. Parakusht i dytë është që të sigurohen 3/4 e fuqisë së votave të vendeve anëtare dhe parakushti i tretë është që t'i kemi 2/3 e votave nga numri i përgjithshëm i anëtarëve të Bankës Ekonomike për Rindërtim dhe Zhvillim.

Dy kushtet e para janë të plotësuara. Ndërsa, nga numri i përgjithshëm i vendeve anëtare në këtë institucion, 37 vende e kanë njohur Kosovën, ndërsa vendet tjera nuk e kanë njohur Kosovën, por janë në proces të njohjes së Kosovës.

Ne kemi konfirmim pozitiv edhe nga disa vende të cilat nuk e kanë njohur pavarësinë e Kosovës e që do të votojnë dhe ta japin votën pozitive për anëtarësimin e Kosovës në këtë institucion. Jemi në kontakt të vazhdueshëm me zyrtarët e Bankës. I kemi përgatitur të gjitha dokumentet e nevojshme për aplikim dhe në momentin kur ne e kemi sinjalin pozitiv, domethënë, na nevojiten pak për të qenë të sigurt edhe në kushtin e tretë, ne sigurisht se do të aplikojmë.

Procedura prej momentit të aplikimit deri në momentin e finalizimit është një kohë, domethënë merr një kohë, ka të bëjë me këto çështje dhe sigurisht se do t'i marrë më së paku 3 muaj deri në përmbyllje të këtij procesi. Mirëpo, Kosova është shumë afër që t'i plotësojë të gjitha kushtet. Një prej arsyeve është se kemi pasur, me disa vende që e kemi konfirmimin pozitiv të votës së tyre, zhvillime të atilla në ato vende që për momentin kanë vakum institucional dhe presim që të konsolidohen qeveritë e këtyre vendeve dhe ne të kemi sinjale nga institucionet e Bankës që të aplikojmë dhe normalisht të kemi edhe konfirmimin pozitiv. Edhe një herë, faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit zoti ministër! Visar, a ke pyetje shtesë?

VISAR YMERI: Faleminderit!

Domethënë, çështja është që a duhet të presim ne si Kosovë dhe kjo është një pyetje që ishte dashur trajtuar jo vetëm në këtë aspekt, por në të gjitha aspektet, që të marrim konsensusin e të gjithëve para se të veprojmë, për shkak se është e mundur që sot Qeveria e Kosovës ta bëjë këtë aplikim dhe pastaj që kjo të procedohet dhe ndoshta edhe aplikimi do ta ndryshonte mendjen e disa shteteve apo do t'i vendoste ato para një trysnie që ta pranojnë apo ta refuzojnë publikisht këtë aplikim. Mirëpo, nuk mund të presim ne që para se të aplikojmë, të gjithë të thonë po, e pastaj të aplikojmë, për shkak se kjo po e shkakton një lloj varësie tejet të madhe edhe në politikën e jashtme të Qeverisë së Kosovës nga vullneti i të tjerëve.

Pra, ne duhet ta tregojmë vullnetin tonë, po që se e kemi, për t'u anëtarësuar në këto institucione dhe pastaj përmes kanaleve të ndryshme edhe ta arrijmë këtë anëtarësim. Pra, anëtarësimi, siç e thatë edhe ju, në Bankën Evropiane për Rindërtim e Zhvillim është veçanërisht i rëndësishëm për këto nevojat infrastrukturore të cilat i kemi. Sigurisht që ju jeni në dijeni, por në vendet në rajon kjo Bankë investon shumë në infrastrukturë. Për shembull, vetëm gjatë vitit të kaluar në Serbi kanë investuar diku 600.000.000 euro në rrjetin e kanalizimeve atje, gjë që ne kemi shumë nevojë këtu në Kosovë. Dhe ne e dimë

që Banka Evropiane për Rindërtim e Zhvillim tashmë e ka zyrën në Kosovë dhe ajo nuk mund të bashkëpunojë me Qeverinë e Kosovës...

(Ndërprerje nga regjia)

KRYESUESI: Ministër, a e do fjalën? Urdhëro!

MINISTRI BEDRI HAMZA: Ju e dini që Banka është prezente në Kosovë, në një formë a në formën tjetër, edhe përmes investimeve të projekteve të caktuara, edhe përmes aksioneve në banka të caktuara, por na dëshirojmë që të shkojmë të koordinuar dhe ne jemi në kontakt ditë me ditë me këtë institucion. Ne kemi konfirmimin e shumicës së nevojshme, na nevojitet pak për të qenë të sigurt që kur të aplikojmë, mos të kemi votë negative dhe pastaj të fillojmë nga e para. Mirëpo, ne nuk kemi pritur as nuk presim që të gjithë anëtarët, nga 63 të kësaj Banke, të konfirmojnë votën e tyre pozitive, por dëshirojmë të sigurohemi që minimum t'i kemi 42 vota, që janë 2/3 të sigurta. Dhe ata e bëjnë konfirmimin paraprakisht, pra para se ne të aplikojmë, e bëjnë konfirmimin dhe pjesa e tyre e madhe e ka bërë konfirmimin pozitiv edhe në mënyrë të shkruar. Prandaj, dëshirojmë që me të gjithë ata që janë duke na përkrahur në këtë proces, me të gjitha vendet që jemi duke kontaktuar, të jemi të sigurt të aplikojmë dhe të anëtarësohemi suksesshëm, qysh jemi anëtarësuar suksesshëm edhe në institucionet tjera. Është me rëndësi shumë të madhe, mirëpo nuk dëshirojmë të hyjmë në një rrugë pa e ditur rezultatin paraprakisht se a do të jetë pozitiv. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit, zoti ministër!

Deputeti Visar Ymeri, pyetje për ministrin Fehmi Mujota. Visari, prapë me kartelë të Albana Fetoshit.

VISAR YMERI: Faleminderit!

Pyetja ime për ministrin Fehmi Mujota ka të bëjë, natyrisht, me projektin e autostradës.

Pra, ministër, kohë më parë, nëse nuk gabohem, ka një javë e ca, zyrtarët e Ministrisë tuaj, më saktësisht këshilltari juaj ka deklaruar se deri tash konzorciumit Behtel&Enka i janë paguar total 320.000.000 euro për punët e kryera në autostradë, që i bie pak a shumë, domethënë për punët e kryera në këto katër segmentet e para të cilat po përgatiten për t'u lëshuar në përdorim, së shpejti.

Me kontratën e nënshkruar në mes Qeverisë së Kosovës dhe këtij konzorciumi, këtij të fundit i jepet e drejta që në secilin segment ta tejkalojë çmimin e marrëveshur paraprakisht edhe për 20%. Pra të arrijë 120% të çmimit të supozuar apo të synuar që figuron aty në kontratë për segmente.

Pyetja ime është: Në këto katër segmente, sa janë në përfundim, a është tejkaluar ky çmim dhe a është arritur maksimumi i lejuar me kontratë?

KRYESUESI: Ministri Mujota!

MINISTRI FEHMI MUJOTA: I nderuari nënkryetar,

Të nderuar ministra,

Të nderuar deputetë,

I nderuari deputet, Visar Ymeri,

Para sa ditësh deri në detaje kam pasur kënaqësinë të raportoj para komisionit funksional mbikëqyrës për zhvillimet jo vetëm në punimet e autostradës, por përgjithësisht në të gjitha projektet e Ministrisë së Infrastrukturës, por megjithatë ju falënderoj shumë për pyetjen shtesë që e keni bërë për të bërë të njohur për opinionin se cila është e vërteta dhe cila është gjendja reale për pagesa që bëhen për autostradën, i cili është një projekt i hapur publik dhe shumë shpejt do ta shohim edhe në praktikë për përdorim, të cilën do ta kenë në shfrytëzim qytetarët e Republikës së Kosovës.

Pra, Ministria e Infrastrukturës e menaxhon realizimin e projektit nacional më të madh - autostradën Vërmicë-Merdar që lidhë korridoret ndërkombëtare 8 dhe 10. Nga fillimi e deri më sot, punimet e ndërtimit të kësaj autostrade kanë përparuar shumë dhe ne jemi të kënaqur që në fund të këtij muaji qytetarët e Republikës së Kosovës do t'i kenë të përfunduara 38 kilometra dhe do të mund t'i shfrytëzojnë ato.

Qeveria e Kosovës dhe Ministria e Infrastrukturës janë angazhuar plotësisht që realizimi i projektit të bëhet sipas kushteve dhe kriterëve të kontratës dhe me standardet ndërkombëtare për këtë lloj ndërtimi.

Deri më tani punimet zhvillohen sipas dinamikës së paraparë në segmentin 1 dhe 4, me gjatësi prej 42 kilometra, ndërsa 38 kilometra, siç e thashë, presim t'i lëshojmë në qarkullim, sigurisht në fillim të nëntorit, me një ceremoni rasti.

Realizimi i punimeve po bëhet edhe sipas parametrave të buxhetit të Republikës së Kosovës. Ndërkohë, Ministria e Infrastrukturës e ka kontraktuar edhe Kompaninë mbikëqyrëse të punimeve, që është Hill International, e cila nga 1 shtatori ka filluar mbikëqyrjen e punimeve dhe ka konstatuar ndërtimin e autostradës me kualitetet e nevojshme ndërkombëtare, për çfarë neve na ka inkurajuar që mbikëqyrja e autostradës ka pasur efektin e vet përmes ekspertëve tanë deri tani deri tani dhe do të vazhdojë edhe më tutje me një cilësi tjetër të karakterit ndërkombëtar.

Në funksion të kontrollit të kostos së projektit, në kontratë është precizuar vlera e tejkalimit të shumës së përcaktuar për çdo segment, që nuk mund të kalojë mbi 20%, pra që është e paraparë me kontratë. Pa u plotësuar ky kriter, nuk mund të fillojnë punët në segmente tjera.

Deri më tani, realizimi i punimeve në segmentet 1 dhe 4, domethënë nga 1 deri në 4, është nën 20%, përkundër faktit se në këto segmente deri më tani janë ndërtuar edhe 17 mbikalime, 10 nënkalime, udhëkryqi i ri në Vërmicë afër kufirit dhe ura e re në mes Kosovës dhe Shqipërisë, të cilat nuk kanë qenë pjesë e kostos fillestare.

Deri më tani janë proceduar pagesat në vlerë rreth 320.000.000 euro, ku përfshihen punët në segmentet 1, 2, 3 dhe 4 në gjatësi mbi 42 kilometra. Pagesat përfshijnë, përveç punëve

ndërtimore, edhe dislokimin e instalimeve, ujë, rrymë, kanalizim, sisteme të ujitjes, si dhe pagesat për kompanitë projektuese, që janë obligim i Qeverisë.

KRYESUESI: Faleminderit, zoti ministër! Zoti deputet, a ke pyetje shtesë? Visar Ymeri!

VISAR YMERI: Faleminderit!

Siç e përmendi..., para komisionit, zyrtari i Ministrisë... tha që në secilin segment është arritur 20%, domethënë deri 20%. Pra, nëse në 4 segmentet kostoja përfundimtare e këtyre 4 segmenteve është 120% e asaj të para caktuar. Ndërkohë, ju tash po thoni që nuk e ka arritur. Pra, nuk e di e cila është e qëndrueshme.

Po pyetja ime ka të bëjë domethënë në të njëjtin drejtim. Meqenëse po e shohim dhe meqenëse është dashur ta dimë që Bechteli, e Bechtel&Enka si konzorcium privat do të bëjë çmos ta maksimalizojë profitin e vet përbrenda Kosovës, a po merr Qeveria e Kosovës ndonjë masë që t'ia kufizojë këtë profit sadopak Bechtelit përbrenda kontratës dhe rregullave ligjore për shkak se, natyrisht, ajo të thuhet që kostoja e deritashme është përbrenda buxhetit, kjo nuk thotë ende asgjë për shkak se paratë e buxhetit edhe ashtu ju po i dedikoni dhe keni mund t'i dedikoni duke planifikuar këtë lloj shpenzimi kaq të madh për...

(Ndërprerje nga regjia)

KRYESUESI: Ministri Mujota!

MINISTRI FEHMI MUJOTA: Faleminderit, deputet Ymeri!

Ajo që thashë pak më parë, pikërisht e vërteton këtë se Qeveria e Republikës së Kosovës, përkatësisht Ministria e Infrastrukturës po ndërmerr të gjitha masat e nevojshme që të mos e dëmtojë kualitetin e punimeve të autostradës, por gjithsesi të ruajë parametrat e paraparë të buxhetit dhe vetë fakti që nuk ka tejkaluar askund asnjë segment mbi 20% të shumës së lejuar me kontratë, nënkupton se kemi një kujdes të jashtëzakonshëm dhe unë ju garantoj juve që mbi bazën e përgjegjësisë, mbi bazën e kompetencave dhe autoriteteve, të autorizimeve që kemi si Qeveri, po edhe si Ministri, do të bëjmë gjithçka që profiti i kompanisë të mos dëmtohet, natyrisht sipas kontratës, por edhe të mos dëmtohet me asnjë cent të buxhetit të Republikës së Kosovës, por çdo cent të jetë i materializuar me rrugën, me cilësinë dhe natyrisht edhe me dinamikën e paraparë të realizimit të projektit.

Me këtë rast, unë dua të tërheq vëmendjen, veç kam edhe pak kohë të them edhe një mendim që tani në shumë segmente të rrugës, të autostradës ka pasur përpjeke, pretendime që ndonjëherë të manipulohet me çështjen e shpronësimeve, madje jo rrallëherë pronarët e kompensuar janë avokuar nga individë të caktuar, madje deri tek avokatë të caktuar për t'i mbrojtur gjoja interesat e tyre, por më tepër ka qenë manipulimi i tyre.

Shpronësimet kanë ndodhur sipas ligjit. Komunikimi me qytetarët ka ndodhur sipas ligjit, të pakënaqurit kanë rrugë ligjore për t'i zgjidhur problemet, por Kosovës më së paku i

duhen barrikadat dhe pengesat në ndërtimin e rrugëve nacionale. Prandaj, ju ftoj të gjithëve të reflektojmë pozitivisht në këtë drejtim dhe të zgjidhim çdo problem, çdo çështje për të cilën kanë të drejtë qytetarët, por për të cilën kemi edhe interes nacional për t'i realizuar së bashku. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit, zoti ministër! U harxhuan të gjitha pyetjet që ishin të parapara për sot. Unë i thërras deputetët të hyjnë në sallë, sepse po hyjmë në aprovime dhe votime ligjesh.

Regjia, thirri deputetët të hyjnë në sallë! Deputetët, në sallë, se ka votime! Vazhdojmë punimet, 61 deputetë janë në sallë.

3. Miratimi i Procesverbalit të mbledhjes së mbajtur më 14 tetor 2011

Pyes, a ka vërejtje në procesverbal? Nuk ka. Atëherë, konsideroj që njëzëri miratohet procesverbali.

Kalojmë në pikën 4 të rendit të ditës:

4. Shqyrtimi i dytë i Projektligjit për prodhimin, grumbullimin, përpunimin dhe tregtimin e duhanit

Komisionet parlamentare e kanë shqyrtuar Projektligjin për prodhimin, grumbullimin, përpunimin dhe tregtimin e duhanit dhe Kuvendit i kanë rekomanduar miratimin e tij me amendamente.

Kryetari i komisionit funksional nuk është paraqitur. Atëherë, procedojmë me amendamentet.

Amendamenti 1.

A ka kush “kundër”?

A abstenon kush? 1 abstenim.

Miratohet amendamenti numër 1.

Amendamenti 2.

A ka “kundër”? Nuk ka.

A ka abstenim? 1 abstenim, Eqrem Kryeziu.

Kalon me shumicë amendamenti numër 2.

Amendamenti 3.

A ka “kundër”? 1 “kundër”.

A ka abstenim? S’ka abstenim.

Kalon amendamenti numër 3.

Votojmë tekstin e projektligjit në tërësi, me amandamentimet e miratuara. Votojmë me elektronikë. Regjia, tash!

Konstatohet se me 55 vota “për”, asnjë “kundër” dhe asnjë abstenim, Kuvendi miratoi Ligjin për prodhimin, grumbullimin, përpunimin dhe tregtimin e duhanit. Faleminderit!

Kalojmë në pikën 5 të rendit të ditës:

5. Shqyrtimi i dytë i Projektligjit për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit për shtetësinë e Kosovës

Komisionet parlamentare kanë shqyrtuar Projektligjin për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit për shtetësinë e Kosovës dhe Kuvendit i kanë rekomanduar miratimin e tij me amendamentet e propozuara.

Komisioni funksional nuk e do fjalën. Atëherë, fjalën e kërkon deputeti Fatmir Xhelili.

FATMIR XHELILI: Faleminderit, nënkryetar!

Përshëndetje për Kabinetin!

Të nderuar deputetë,

Faktikisht, në emër të komisionit dola për të treguar që komisioni e ka dhënë vizën bashkë me amendamentet e propozuara për të kaluar këtë ligj dhe ju lutem që ta miratoni, se ky ligj i plotëson të gjitha kriteret për procedurat, për marrjen e shtetësisë, dorëzimin e shtetësisë dhe dhënien e shtetësisë.

Andaj, ju lus, deputetë të nderuar, që ta aprovoni ligjin në fjalë.

KRYESUESI: Faleminderit, zoti deputet, për shpjegimet!

Për këtë projektligj janë propozuar gjithsej 3 amendamente të komisionit funksional. Në sallë kemi tash 66 deputetë.

Votojmë amendamentin 1.

A ka “kundër”? 1 “kundër”.

A ka që abstenojnë? Nuk ka.

Atëherë, konsideroj që amendamenti numër 1 me shumicë, pra me një “kundër” aprovohet.

Amendamenti numër 2.

A ka “kundër”? 1 “kundër”.

A ka abstenim? 1 abstenim.

Aprovohet amendamenti 2, me shumicë, me një “kundër” dhe një abstenim.

Amendamenti numër 3.

A ka kush “kundër”? Një “kundër”.

A ka abstenim? Nuk ka abstenim.

Pra, aprovohet amendamenti 3 me shumicë, me një votë “kundër”.

Tash i votojmë projektligjin në tërësi, me amendamentet e miratuara. Regjia bëhuni gati, votojmë tash!

Konstatohet që me 56 vota “për”, asnjë “kundër” dhe asnjë abstenim, Kuvendi miratoi Ligjin për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit për shtetësinë e Kosovës. Faleminderit!

Kalojmë në pikën 6 të rendit të ditës:

6. Shqyrtimi i dytë i Projektligjit për Akademinë e Kosovës për Siguri Publike

Komisionet parlamentare e kanë shqyrtuar Projektligjin për Akademinë e Kosovës për Siguri Publike dhe Kuvendit i kanë rekomanduar miratimin e tij, me amendamentet e propozuara.

Raportuesi i komisionit funksional, a e do fjalën? Po, deputeti Rexhep Selimi e ka fjalën.

REXHEP SELIMI: Faleminderit, zoti kryesues!

Komisioni për Punë të Brendshme, Siguri dhe Mbikëqyrje të FSK-së në pajtim me nenin 57, 67 dhe 68 të Rregullores, në mbledhjen e mbajtur më 29.7.2011 dhe 31.10.2011 shqyrtoi Projektligjin për Akademinë e Kosovës për Siguri Publike edhe vendosi që Kuvendit t’i paraqesë këtë raport lidhur me Projektligjin për Akademinë e Sigurisë Publike, raport të cilin ju ftojme ta votojë. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Në sallë janë 68 deputetë. Ju informoj që komisioni funksional i ka propozuar dhe miratuar 11 amendamente. Fillojmë me votimet e amendamenteve.

Amendamenti 1.

A ka kush “kundër”? Nuk ka.

A ka abstenim? Nuk ka.

Njëzëri konsideroj që votohet amendament 1.

Amendamentin 2.

A ka “kundër”?

A ka abstenim? Nuk ka.

Edhe amendamenti 2 kalon me të gjithë “për”.

Amendamenti 3.

A ka “kundër”?

A ka abstenim? Nuk ka as “kundër”, as abstenim.

Kalon amendamenti numër 3.

Amendamenti 4.

“Kundër” a ka? Abstenim? S’ka.

Kalon amendamenti numër 4.

Amendamenti 5.

A ka “kundër”? Nuk ka. Abstenim? Nuk ka.

Kalon amendamenti numër 5.

Amendamenti numër 6.

A ka kush votë “kundër”? Nuk ka. Abstenim? Nuk shoh.

Kalon amendamenti 6.

Amendamenti 7.

“Kundër”? S’ka. Abstenim? Nuk ka.

Kalon amendamenti numër 7.

Amendamenti 8.

A ka “kundër”? S’ka. Abstenim? S’ka.

Kalon amendamenti 8.

Amendamenti numër 9.

“Kundër” nuk ka, abstenim nuk ka.

Kalon amendamenti numër 9.

Amendamenti 10.

“Kundër” s’ka. Abstenim, s’ka.

Kalon amendamenti numër 10.

Amendamenti 11.

“Kundër”, nuk shoh, abstenim, nuk ka.

Kalon amendamenti numër 11.

Në sallë janë 68 deputetë. Regjinë e lus të bëhet gati, votojmë të plotë amendamentet dhe ligjin në tërësi. Votojmë tash!

Me 55 vota “për”, asnjë abstenim dhe asnjë “kundër”, Kuvendi miratoi Ligjin për Akademinë e Kosovës për Siguri Publike. Faleminderit!

Kalojmë në pikën 7 të rendit të ditës, që është:

7. Shqyrtimi i dytë i Projektligjit për partneritet publiko-privat

Komisionet parlamentare kanë shqyrtuar Projektligjin për partneritet publiko-privat dhe Kuvendit i kanë rekomanduar miratimin e tij, me amendamentet e propozuara.

Kryetarja e Komisionit funksional për Buxhet dhe Financa, Safete Hadërgjonaj e do fjalën.

SAFETE HADËRGJONAJ: Faleminderit, nënkryetar!

I nderuari ministër,
Të nderuar deputetë,
Komisioni për Buxhet dhe Financa, në pajtim me Rregullën 35, pika 4, 36 dhe 46 të Rregullores së Punës së Kuvendit, në mbledhjet e mbajtura më datat 21 shtator, 29 shtator dhe 11 tetor ka shqyrtuar Projektligjin numër 04 L45 për partneritet privato-publik, të propozuar nga Qeveria dhe ka paraqitur raportin me rekomandime, për miratim.

Raporti me rekomandime është miratuar unanimisht nga të gjithë anëtarët e Komisionit për Buxhet dhe Financa, kështu që rekomandoj që ky raport me rekomandime të votohet edhe nga deputetët e Parlamentit. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit, zonja kryetare e komisionit!
Dëgjuam, pra, raportin dhe vlerësimet e komisionit. Ju njoftoj që janë propozuar gjithsej 13 amendamente, 12 nga komisioni funksional dhe 1 amendament, që është numri 10, nga deputeti Bekim Haxhiu, por pa përkrahje nga komisioni funksional.

Bekim, nëse do, kur të vijë koha, ta jap fjalën, patjetër. Fillojmë me votimin e amendamenteve.

Amendamenti 1.
A ka kush “kundër”? Nuk ka.
Abstenim, nuk ka.
Kalon amendamenti numër 1.

Amendamenti 2.
A ka “kundër”? Nuk ka.
Abstenim, s’ka.
Kalon amendamenti numër 2.

Amendamenti numër 3.
A ka “kundër”? S’ka.
Abstenim, s’ka.
Kalon amendamenti 3.

Amendamenti 4.
A ka “kundër”? S’ka.
Abstenim, nuk ka.
Kalon amendamenti 4.

Amendamenti 5.
“Kundër” nuk shoh,
Abstenim, nuk ka.
Kalon amendamenti 5.

Amendamenti 6.
A ka “kundër”? S’ka.

Abstenim, s'ka.
Kalon amendamenti 6.

Amendamenti 7 .
"Kundër", nuk ka.
Abstenim, s'ka.
Kalon amendamenti 7.

Amendamenti 8.
"Kundër", nuk shoh.
Abstenim, jo.
Kalon amendamenti numër 8.

Amendamenti numër 9.
"Kundër", nuk ka.
Abstenim, nuk ka.
Kalon amendamenti numër 9.

Kemi amendamentin numër 10, të deputetit Bekim Haxhiu, pa përkrahje të komisionit funksional. Ky është variacioni i 9-shit, a është i 9-shit?

Ne votuam, megjithatë votuam, s'votuam, unë ia jap fjalën, sido që të jetë, le ta artikulojë, se i premtova Haxhiut që do ta ketë fjalën.
Propozimin tënd arsyetoje.

BEKIM HAXHIU: Faleminderit, kryesues!

Të nderuar kolegë deputetë,
Amendamenti i propozuar ka të bëjë me zgjidhjen e pronësisë së stadioneve të futbollit dhe procedurës së partneritetit publik për to. Të nderuar, zgjidhja e përkatësisë së stadiumit të futbollit, çështje e domosdoshme për futbollin kosovar, kur futboli kosovar është para pranimit në UEFA dhe FIFA. Kjo kishte për ta ndihmuar zhvillimin e futbollit kosovar dhe kishte për të krijuar parakushte, përmirësime në këtë fushë nga ana e FIFA-s dhe UEFA-s dhe organizmave tjerë.

Kjo çështje është fakt që është paksa komplekse për ata të cilët nuk janë marrë me këtë veprimtari, por koha po vjen që ne duhet të zgjidhim edhe këto çështje dhe të krijojmë parakushte për zhvillim futbollit.

Amendamenti i propozuar hap rrugën për zhvillim në futboll, mirëpo për shkak se kjo çështje rregullohet tani edhe me Ligjin për sport, të cilin Qeveria më pastaj e ka sjellë në Kuvend, amendamentin e propozuar në Ligjin për partneritetin publiko-privat e tërheq, ngase kjo çështje do të rregullohet në Ligjin për sport.

Të nderuar kolegë deputetë,
I nderuari kryesues,

Unë kam dorëzuar në Ligjin për AKP-në 5 amendamente. Ky ligj ka qenë në lexim të dytë, janë paraqitur nga ana e administratës së Kuvendit si amendamente pa përkrahje të komisionit, ndërsa kur kam marrë ligjin të botuar në “Gazetën zyrtare”, e shoh që 3 amendamente të propozuara nga unë, janë inkorporuar në ligj dhe atë: neni 12 pika 2, neni 13 pika 1 dhe neni 15 pika 3.

I nderuar kryesues,

Këtë e potencova në fund, si lëshim të Administratës së Kuvendit, kur ne po mundohemi të japim kontributin në hartimin e ligjeve dhe po propozojmë amendamente dhe kur diskutohen ligje në fjalë në komisione, ne nuk ftohemi për të marrë pjesë në mbledhje të komisionit për të dhënë arsyeshmërinë e amendamenteve dhe kontributin tonë, edhe pse nuk jemi pjesë të disa komisioneve, ku ne po tentojmë të japim kontributin tonë në hartimin e ligjeve. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Absolutisht, është e drejta e juaj, bile është e detyrueshme, e moralshme edhe e dobishme, kush bën amendamente, të shkojë t’i mbrojë në komision. Pra, mos të krijojmë moskuptim, ky është amendament i veçantë i deputetit Bekim Haxhiu, që nuk e ka përkrahjen e komisionit funksional.

Kryetarja e komisionit funksional e ka fjalën.

SAFETE HADËRGJONAJ: Faleminderit, nënkryetar!

Komisioni për Buxhet dhe Financa e ka pasur amendamentin e deputetit Bekim Haxhiu, e ka shqyrtuar me seriozitet. Mbledhja e komisionit ka qenë publike edhe pjesëmarrja ka mund të jetë e kujtdo qoftë aty. Kanë qenë edhe sqarime të detajizuara në amendamentin që e ka propozuar deputeti, kështu që Komisioni për Buxhet dhe Financa nuk ka qenë i pa njoftuar rreth arsyeshmërisë së amendamentit që e ka bërë deputeti.

Megjithatë, komisioni nuk e ka përkrahur këtë amendament, sepse ky ligj nuk i rregullon raportet pronësore në pronësinë publike, respektivisht shoqërore.

Gjithashtu, edhe kur është rasti të pronësia private, fitimi i pronësisë me parashkrim duhet të bëhet me procedurë gjyqësore, nëse janë plotësuar kushtet e parapara me Ligjin për pronësinë dhe të drejtat tjera sendore.

Si rezultat, Ligji për partneritet privato-publik nuk është Ligj për transformimin, as për privatizimin e pronës shoqërore. Çështja e privatizimit të pronës shoqërore është e rregulluar me ligjet tjera dhe jo me Ligjin për partneritet privato-publik.

Komisioni për përmbajtjen e amendamentit të propozuar ka vlerësuar se për zhvillimin e infrastrukturës së stadumeve, mund të shfrytëzohet Ligji për partneritet privato-publik, domethënë për zhvillimin e infrastrukturës. Këtë mund ta bëjnë komunat në territorin e të cilave ndodhen stadiumet dhe që kjo pronë ende konsiderohet pronë shoqërore-publike në shfrytëzim të komunës.

Dhënia e stadioneve me ndonjë projekt të partneritetit privato-publik, nuk do të thotë se me atë rast ndryshohet pronësia. Projektet e partneritetit privato-publik jepen vetëm për të zhvilluar infrastrukturën, por pa e ndryshuar pronësinë. Ky ka qenë arsyetimi që është dhënë në Komisionin për Buxhet dhe Financa dhe për këtë arsye ky amendament i propozuar nga deputeti, i cili ka ardhur i propozuar me arsye të mjaftueshme, nuk është përkrahur nga anëtarët e komisionit. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Unë ju thërras të bëheni gati, edhe deputetët, edhe regjinë. Votohet amendamenti i paraqitur 10, i deputetit Bekim Haxhiu, që nuk e ka përkrahjen e komisionit funksional. Votojmë tash!

Faleminderit! Konstatohet që me 43 vota “jo”, 9 vota “po” dhe 7 abstenime, nuk kalon amendamenti numër 10, i propozuar nga deputeti Bekim Haxhiu.

Kalojmë në amendamentin 11.

A ka “kundër”? Nuk ka.

A ka abstenim? Nuk ka.

Kalon amendamenti 11.

Amendamenti 12.

A ka “kundër”? S’ka.

Abstenim? Nuk ka.

Kalon amendamenti 12.

Amendamenti 13.

A ka “kundër”? Nuk ka.

Abstenim, nuk ka.

Kalon amendamenti 13.

Tash, bëhemi gati edhe regjia, edhe deputetët, për ta votuar ligjin në tërësi, bashkë me amendamentet e sapo votuara. Votojmë, tash!

Momentalisht 69 deputetë janë në sallë, se po lëvizin çdo sekondë. Me 55 vota “për”, 4 “kundër” dhe asnjë abstenim, Kuvendi miratoi Ligjin për partneritet publiko-privat. Faleminderit!

Kalojmë në pikën 8, që është:

8. Shqyrtimi i dytë i Projektligjit për statistikat zyrtare të Republikës së Kosovës

Komisionet parlamentare kanë shqyrtuar Projektligjin për statistikat zyrtare të Republikës së Kosovës dhe Kuvendit i kanë rekomanduar miratimin e tij, me amendamentet e propozuara.

Ftoj raportuesen e Komisionit funksional për Arsim dhe Administratë Publike, deputeten Teuta Haxhiu, që të paraqesë dhe ta arsyetojë raportin me rekomandime. Zonja Haxhiu!

TEUTA HAXHIU: Faleminderit, nënkryetar!

Të nderuar deputetë,

Në pajtim me nenet 57, 67 dhe 68 të Rregullores së Kuvendit, Komisioni për Arsim, Kulturë, Rini, Sport, Administratë Publike, Qeverisje Lokale dhe Media ka shqyrtuar Projektligjin për statistikën zyrtare të Republikës së Kosovës.

Komisioni vlerësoi se dispozitat e Projektligjit me amendamentet e propozuara ofrojnë kornizë ligjore për organizimin, prodhimin dhe publikimin e statistikave zyrtare. Komisionet e përhershme kanë shqyrtuar amendamentet e propozuara nga komisioni funksional dhe sipas rekomandimeve të tyre del se:

- Amendamentet e propozuara kanë bazën juridike në Kushtetutën e Republikës së Kosovës,

- Amendamentet e propozuara nuk kanë implikime buxhetore,

- Amendamentet e propozuara nuk cenojnë parimet e përgjithshme të Legjislacionit të BE-së,

- Amendamentet e propozuara nuk cenojnë dhe nuk prekin të drejtat dhe interesat e komuniteteve.

Andaj, Komisioni njëzëri i rekomandon Kuvendit miratimin e Projektligjit me amendamentet e propozuara dhe ju ftoj që t'i votoni ato. Për vëmendjen tuaj, tek amendamenti 8 është bërë një lëshim teknik, gjë është përsëritur dy herë ky amendament. Faleminderit, kryesues!

KRYESUES: Faleminderit, zonja deputete, raportuese e komisionit! Ju e dëgjuat, atëherë ju njoftoj që për këtë projektligj janë propozuar gjithsej 19 amendamente dhe të gjitha janë këto të komisionit funksional, të cilit sapo i shpjegoi kryetarja e komisionit, raportuesja e komisionit. Kalojmë në votimet e amendamenteve.

Amendamenti 1.

A ka “kundër”? Nuk ka.

Abstenim, s’ka.

Kalon amendamenti numër 1.

Amendamenti 2.

“Kundër”, nuk ka.

Abstenim, nuk ka.

Kalon amendamenti 2.

Amendamenti 3.

“Kundër”? Nuk ka.

Abstenim, s’ka.

Kalon amendamenti 3.

Amendamenti 4.
“Kundër”, nuk shoh.
Abstenim, jo.
Kalon amendamenti 4.

Amendamenti 5.
“Kundër” s’ka.
Abstenim, jo.
Kalon amendamenti 5.

Amendamenti 6.
“Kundër”, nuk shoh.
Abstenim, s’ka.
Kalon amendamenti numër 6.

Amendamenti 7.
“Kundër”, s’ka.
Abstenim, s’ka.
Kalon amendamenti 7.

Amendamenti 8.
“Kundër”, s’ka.
Abstenim, s’ka.
Kalon amendamenti 8.

Amendamenti 9.
“Kundër”, nuk ka. Abstenim, s’ka.
Kalon amendamenti 9.

Amendamenti 10.
“Kundër”, 4.
Abstenim, s’ka.
Votohet amendamenti 10, me 4 vota “kundër”.

Amendamenti 11.
“Kundër”, s’ka.
Abstenim, nuk ka.
Kalon amendamenti 11.

Amendamenti 12.
“Kundër”, nuk shoh.
Abstenim, nuk ka.
Kalon amendamenti 12.

Amendamenti 13.
“Kundër”, s’ka.

Abstenim, s'ka.
Kalon amendamenti 13.

Amendamenti 14.
"Kundër", s'ka.
Abstenim, s'ka.
Kalon amendamenti 14.

Amendamenti 15.
"Kundër", s'ka.
Abstenim, s'ka.
Kalon amendamenti 15.

Amendamenti 16.
"Kundër", s'ka.
Abstenim, s'ka.
Kalon amendamenti 16.

Amendamenti 17.
"Kundër", s'ka.
Abstenim, s'ka.
Kalon amendamenti 17.

Amendamenti 18.
"Kundër", jo.
Abstenim, jo.
Kalon amendamenti 18.

Amendamenti 19, që është i fundit.
"Kundër", s'ka.
Abstenim, s'ka.
Kalon amendamenti 19.

Kemi 67 deputetë në sallë, bëhemi gati të gjithë me regjinë që të votojmë gjithë këto amendamente dhe ligjin në tërësi. Votojmë, tash!

Me 61 votë "për", asnjë abstenim dhe asnjë "kundër", Kuvendi miratoi Ligjin për statistikat zyrtare të Republikës së Kosovës. Faleminderit!

Vazhdojmë tutje me pikën numër 9, që është:

9. Shqyrtimi i dytë i Projektligjit për të drejtat e autorit dhe të drejtat e përafërta

Ftoj raportuesen e Komisionit funksional për Arsim, deputeten Lirije Kajtazi, që para deputetëve ta arsyetojë raportin me rekomandime. Zonja Lirije!

LIRIJE KAJTAZI: Faleminderit!

I nderuari kryesues,

Të nderuar deputetë,

Po ashtu dhe ministra, është këtu edhe ministri i Kulturës, që besoj do të përpiqet në punën e realizimit të këtij ligji.

Në pajtim me nenet 57, 67 dhe 68 të Rregullores së Kuvendit, Komisioni për Arsim, Kulturë, Rini, Sport, Administratë Publike, Qeverisje Lokale dhe Medie ka shqyrtuar Projektligjin numër 04 L-65, për të drejtat e autorit dhe të drejtat e përafërta.

Komisioni vlerësoi se dispozitat e projektligjit me amendamentet e propozuara ofrojnë kornizë ligjore për avancimin e mëtejme dhe mbrojtjen më të mirë ligjore të të gjitha çështjeve që kanë të bëjnë me të drejtat e autorit dhe të drejtat e përafërta, si dhe menaxhimin e tyre. Po ashtu, edhe komisionet e përhershme e kanë shqyrtuar amendamentet e propozuara dhe është në pajtueshmëri me to. Andaj, komisioni i rekomandon Kuvendit miratimin e projektligjit me amendamentet e propozuara dhe ju ftojme që t'i votoni ato. Ju faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit zonja deputete Lirije Kajtazi!

Dëgjuam raportuesen e komisionit funksional. Ju njoftoj që ky komision ka propozuar gjithsej 5 amendamente në këtë projektligj dhe ju ftoj që t'i votojmë.

Amendamenti 1.

“Kundër” s’ka.

Abstenim s’ka.

Kalon.

Amendamenti 2.

“Kundër”, nuk shoh.

Abstenim, nuk shoh.

Kalon.

Amendamenti 3.

“Kundër”, nuk ka.

Abstenim, nuk ka.

Kalon.

Amendamenti 4.

“Kundër”, s’ka.

Abstenim, s’ka.

Kalon.

Amendamenti numër 5, i fundit.

“Kundër”, nuk ka.

Abstenim, nuk ka.

Kalon.

Në sallë kemi 72 deputetë. Ju ftoj të bëhemi gati, regjia gati, që ta votojmë ligjin në tërësi, bashkë me amendamentet e sapo votuara. Votojmë tash!

Me 66 vota “për”, një abstenim dhe asnjë “kundër”, Kuvendi miratoi Ligjin për të drejtat e autorit dhe të drejtat e përafërta. Faleminderit!

Kalojmë në pikën numër dhjetë të rendit të ditës, që është:

10. Shqyrtimi i Raportit të Komisionit për Punë të Jashtme për mbikëqyrjen e zbatimit të Ligjit për Ministrinë e Punëve të Jashtme dhe Shërbimin Diplomatik të Republikës së Kosovës

Komisioni funksional ka bërë mbikëqyrjen e zbatimit të Ligjit për Ministrinë e Punëve të Jashtme dhe Shërbimin Diplomatik të Republikës së Kosovës dhe Kuvendit i ka paraqitur raportin me rekomandime.

Raportuesi i komisionit funksional, deputeti Hydajet Hyseni -Kaloshi, do të flasë për arsyetimin e raportit me rekomandime.
Urdhëro, zoti Hydajet!

HYDAJET HYSENI: Faleminderit, zoti nënkryetar!

Zonja dhe zotërinj deputetë,

Më lejoni që në mungesë të kryetarit të Komisionit, zotit Albin Kurti, ta paraqes këtë raport të komisionit. Dhe, desha ta theksoj këtë me qëllim edhe në emër të kryetarit të komisionit, i cili ka udhëhequr gjithë punën në hartimin e këtij raport dhe praktikisht ka bërë punën më të madhe edhe në grupin punues.

Në pajtim me dispozitat e Kushtetutës dhe të Rregullores së Kuvendit të Kosovës për mbikëqyrjen parlamentare të ekzekutivit, dhe në pajtim me Planin e veprimit të Kuvendit të Kosovës lidhur me agjendën evropiane dhe obligimet që dalin nga Raporti i Progresit, Komisioni për Punë të Jashtme i Kuvendit të Kosovës ka formuar Grupin punues për mbikëqyrjen e Ligjit për punë të jashtme të Kosovës dhe Shërbimin Diplomatik e Konsullor, ka kontaktuar, sipas praktikave tashmë të standardizuara, përfaqësuesit e Ministrisë së Punëve të Jashtme, në disa raste, ka marrë prej tyre informacione dhe raporte të nevojshme, përfshirë këtu edhe listën e akteve nënligjore të miratuara, ka intervistuar disa përfaqësues të shërbimeve diplomatike e konsullore, ka bërë edhe një pyetësor ndoshta si një praktikë e re që u është dërguar të gjitha shërbimeve diplomatike e konsullore lidhur me çështjet e përfshira në raport dhe, si rezultat i gjithë kësaj pune, në frymë vërtet konstruktive ka hartuar raportin që keni përpara.

Ky raport është shqyrtuar në komision dhe është miratuar njëzëri. Komisioni dhe para këtij grupi punues ka konstatuar se Ligji për Ministrinë e Punëve të Jashtme dhe Shërbimin Diplomatik të Republikës së Kosovës, së bashku me Ligjin për plotësimin dhe ndryshimin e tij, është zbatuar dhe është duke përmbushur objektivat e tij.

Është konstatuar, po ashtu, se janë miratuar po thuaj se të gjitha aktet e parapara nënligjore, por komisioni ka konstatuar edhe mangësi të caktuara të cilat janë përfshirë në rekomandimet që keni përpara.

Megjithatë, me lejen tuaj, për hir edhe të opinionit, do të dëshiroja t'i lexoja këto rekomandime:

1. Qeveria, në bashkëpunim me Ministrinë e Punëve të Jashtme, të sigurojë hapësirë të mjaftueshme dhe të përhershme për ushtrimin e veprimtarisë së Ministrisë, e nuk e ka.
2. Qeveria, me rastin e hartimit të Projekt-buxhetit për vitin 2012, të rrisë mjetet buxhetore për Ministrinë e Punëve të Jashtme, sipas propozimit të Ministrisë së Punëve të Jashtme, me qëllim të përmbushjes së obligimeve të saja, janë konstatuar mangësi.
3. Ministria e Punëve të Jashtme të plotësojë dhe ndryshojë udhëzimin administrativ numër 06/2009 për plotësim-ndryshimin e Udhëzimit administrativ numër 01/2008 për organizimin dhe strukturimin e brendshëm të Ministrisë së Punëve të Jashtme, duke përfshirë në këtë kuadër edhe Departamentin për Azinë e Afrikën, që mungon.
4. Ministria e Punëve të Jashtme të ndërmarrë hapa për koordinimin e punëve me ministritë e tjera, e veçanërisht atë të Tregtisë dhe Industrisë, me qëllim të krijimit të kushteve për promovimin e tregtisë dhe investimeve të huaja në Kosovë.
5. Ministria e Punëve të Jashtme të shtojë koordinimin me ambasada dhe përfaqësi diplomatike, në mënyrë që të përçohen informacionet, e sidomos qëndrimet zyrtare të Qeverisë së Kosovës dhe të përfaqësuesve tanë.
6. Ministria e Punëve të Jashtme të shtojë koordinimin dhe me ministri tjera për vizitat jashtë vendit, ku kërkohet angazhimi i ambasadave dhe organizimi e bashkërendimi i këtyre vizitave, do të mund të thuhej edhe përfshirjen më shumë të përfaqësuesve të zgjedhur.
7. Ministria e Punëve të Jashtme të konsiderojë përfaqësimin e përbashkët me Shqipërinë dhe me vendet tjera mike, për arsye se kapacitetet njerëzore dhe financiare nuk u mundësojnë ambasadave ekzistuese që të shtrijnë aktivitetin më gjerë se në shtetin ku i kanë zyrat, e as të rrisin numrin e personelit të angazhuar në këto përfaqësi.
8. Ministria e Punëve të Jashtme të shqyrtojë nevojën e ndryshimit, të plotësimit të udhëzimeve administrative lidhur me veprimet financiare të misionëve diplomatike në përputhje me Ligjin për prokurimin publik, të koordinohen veprimet nga sferat e politikës së jashtme në mes të Ministrisë të Punëve të Jashtme dhe mekanizmave tjerë për zbatimin e saj.
9. Ministria e Punëve të Jashtme të raportojë në mënyrë permanente në Komision lidhur me aktivitetet e saj, përfshirë edhe zbatimin e rekomandimeve të përfshira në këtë raport.

Ju faleminderit, zonja dhe zotërinj!

KRYESUESI: Faleminderit, zoti Hyseni!

Tash deklaratat e shefave të grupeve ose të përfaqësuesve rreth këtij raporti për zbatimin e ligjit.

Kush flet në emër të PDK-së, ose s'kanë nevojë?

Në emër të Aleancës për Ardhmërinë e Kosovës?

Në emër të "Vetëvendosjes", s'ka nevojë?

Në emër të SLS-së?

Në emër të Koalicionit Kosovës së Re?

Në emër të LDK-së, unë them që e përkrahim plotësisht raportin, po flas edhe si anëtar i këtij komisioni, edhe si i mandatar t'jua them këtë qëndrim të grupit.

Atëherë, ju thërras që ta votojmë me elektronikë këtë raport, bashkë me rekomandime.

Votojmë tash:

Kemi 68 deputetë në sallë.

Konstatoj se me 54 vota "për" dhe një "kundër", miratohet Raporti me rekomandime i Komisionit për Punë të Jashtme lidhur me zbatimin e Ligjit për Ministrinë e Punëve të Jashtme dhe Shërbimin Diplomatik të Republikës së Kosovës.

Kalojmë në pikën e njëmbëdhjetë të rendit të ditës, që është:

11. Shqyrtimi i Raportit të Komisionit për Arsim, Kulturë, Rini, Sport, Administratë Publike, Qeverisje Lokale dhe Media për mbikëqyrjen e zbatimit të Ligjit për qasje në dokumente zyrtare

Komisioni funksional ka bërë mbikëqyrjen e zbatimit të Ligjit për qasje në dokumentet publike dhe Kuvendit i ka paraqitur raportin me rekomandime.

Raportuesi i komisionit funksional është deputeti Sadri Ferati, që do t'i arsyetojë raportin dhe rekomandimet.

Deputeti Sadri Ferati, urdhëroni!

SADRI FERATI: Faleminderit!

I nderuar kryesues,

Kabinet qeveritar,

Të nderuar kolegë,

Komisionit për Arsim, Kulturë, Rini, Sport, Administratë Publike, Qeverisje Lokale dhe Media, në bazë të nenit 73 të Rregullores së Kuvendit, në kuadër të fushëveprimtarisë së vet ka bërë monitorimin e Ligjit për qasje në dokumente publike dhe Kuvendit i raporton për nivelin e zbatimit të tij me sa vijon.

Komisioni, pas mbledhjeve të mbajtura radhazi dhe vizitave të realizuara në komuna, agjencionet e pavarura dhe institucionet qendrore, ka bërë mbikëqyrjen e zbatimit të Ligjit për qasje në dokumente publike.

Lidhur me monitorimin e zbatimit të këtij ligji, Komisioni aktivitetin e tij e ka realizuar duke u bazuar në planin e veprimit për monitorimin e ligjit.

Gjatë procesit të monitorimit të ligjit, Komisioni realizoi aktivitete, si dhe takime të rregullta me qëllim të koordinimit dhe planifikimit të aktiviteteve, takime zyrtare, të realizuara në institucionet qendrore e lokale dhe agjencione të pavarura dhe dëgjim publik.

Në takimet e rregullta janë analizuar të dhënat dhe informacionet e marra nga vizitat e realizuara dhe me këtë rast janë realizuar gjashtë vizita në terren në institucione qendrore, si Ministria e Administratës Publike, pastaj ato lokale, komuna e Gjakovës, Mamushës, Prizrenit, institucionet e pavarura, si Avokati i Popullit dhe Agjencia Kosovare e Privatizimit.

Ndërsa, sipas raportit me shkrim të Ministrisë së Administratës Publike dhe Pushtetit Lokal, komunat e Republikës së Kosovës, gjatë vitit 2010, kanë pranuar gjithsej 34 kërkesa për qasje në dokumente zyrtare.

Komunat nuk posedojnë njësitin dhe zyrtarin për qasje në dokumente publike, kështu që qytetari që në momentin e parë ballafaqohet me problemin se kur dhe ku duhet të drejtohet.

Sipas tyre ligji ka probleme për zbatim, një ndër problemet të sipërhënuara për zbatimin e ligjit ata cekën se asnjë institucion nuk posedon formularë të cilët qytetari duhet t'i plotësojë me rastin e paraqitjes së kërkesës për qasje në dokumente publike, institucionet nuk kanë staf të trajnuar për klasifikimin e dokumenteve.

Komisioni gjatë vizitës në Ministrinë e Administratës Publike është njoftuar se Ministria është në përpjekje, por akoma nuk e ka finalizuar, pra nuk i ka nxjerrë aktet nënligjore, gjegjësisht udhëzimin administrativ dhe nuk e ka caktuar akoma zyrtarin përkatës, siç parashihet në nenin 5.

Sa i përket vizitës në Agjencionin Kosovar të Privatizimit, Komisioni është njoftuar se Agjencioni ka pasur 15 kërkesa të pranuar për qasje në dokumente publike, të cilave u është përgjigjur brenda afateve të parapara.

Qeveria e Kosovës nuk ka përcaktuar akoma se cila njësi do të ketë për detyrë të përgatisë raport vjetor gjithëpërfshirës për trajtimin e kërkesave për qasje në dokumente publike në të gjitha institucionet e Republikës së Kosovës dhe një raport i tillë ende nuk është dërguar në Kuvendin e Kosovës, gjegjësisht në Komision.

Pas përfundimit të aktiviteteve të planifikuara Komisioni hartoi raportin përfundimtar të monitorimit të zbatimit të Ligjit për qasje në dokumente publike, i cili u shqyrtua dhe u miratua nga Komisioni, më 13.10.2011, dhe me këtë rast Komisioni ka nxjerrë tri përfundime dhe tri rekomandime në lidhje me këtë.

Përfundim 1.

Komisioni gjatë monitorimit të Ligjit për qasje në dokumente publike, ka konstatuar se jo të gjitha institucionet e Republikës së Kosovës kanë caktuar zyrtarin përgjegjës për trajtimin e kërkesave të qytetarëve.

Rekomandim:

Që të gjitha institucionet e Republikës së Kosovës të caktojnë personin, zyrtarin përgjegjës për pranimin dhe shqyrtimin e kërkesave për qasje në dokumente publike, ashtu siç parashihet në nenin 5.1 të ligjit në fuqi.

Përfundimi 2.

Komisioni gjatë monitorimit të Ligjit për qasje në dokumente publike ka konstatuar se Ministria e Administratës Publike akoma nuk i ka nxjerrë përfundimisht aktet nënligjore sipas këtij ligji.

R e k o m a n d i m

Komisioni rekomandon që Ministria përkatëse t'i nxjerrë aktet nënligjore sipas nenit 16.4.

Konstatimi 3.

Komisioni gjatë monitorimit të Ligjit për qasje në dokumente publike ka konstatuar se jo të gjitha institucionet e Republikës së Kosovës kanë evidenca lidhur me kërkesat e qytetarëve për qasje në dokumente publike, si dhe ka konstatuar se ka mungesa, ka munguar raporti në baza të rregullta.

Rekomandimi 3.

Të gjitha institucionet e Republikës së Kosovës të hartojnë raportin vjetor për vitin paraprak, në të cilin do të përfshihet numri i rasteve në të cilat institucioni ka lejuar qasjen, si dhe numri i rasteve kur institucioni ka refuzuar qasjen, përfshirë këtu dhe arsyet e refuzimit për qasje në dokumente publike dhe që këtë raport t'ia adresojë njësisë përkatëse pranë Zyrës së Kryeministrit, pra Qeverisë së Republikës së Kosovës, ashtu siç parashihet në nenet 20.3, 20.4 dhe 20.5.

Dhe, tani, nëse më lejohet shkurtazi të paraqes edhe qëndrimin e Grupit Parlamentar të LDK-së, nëse është e mundshme që të mos marrë fjalën përsëri.

Atëherë, ju faleminderit, zoti kryesues!

Pra, duke u bazuar dhe në punën e Komisionit gjatë vizitave, debateve publike që ka bërë me qytetarët, shoqërinë civile, me institucionet qendrore, lokale dhe agjencionet, ne mund të konstatojmë se në këtë pikë akoma nuk e kemi arritur nivelin e dëshiruar. Duke e ditur se kjo pikë, pra monitorimi i zbatimit të Ligjit në qasje në dokumente publike ka qenë edhe një prej sfidave të theksuara në Raportin e Progresit, çështje pra që na ka ikur, por do të kishim dëshiruar që në këtë drejtim të jemi të gjithë të mobilizuar dhe se në këtë aspekt të arrimë progres që në raportin e ardhshëm të mos evidentohet ngecje në këtë pikë.

Dhe mbi të gjitha edhe pse ekziston rregullorja, vendimi i Qeverisë dhe udhëzimi administrativ i Ministrisë së Pushtetit Lokal, për transparencë dhe qasje në dokumente zyrtare, shihet se në këtë aspekt shumë institucione akoma nuk e kanë bërë punën e vet, ani pse në aspektin e shërbimit mund të themi se kjo është një fushë që deri diku kënaq, por nuk mund të justifikohet mungesa e shumë të dhënave që të gjitha institucionet mund të kenë që në ueb faqet e tyre, që qytetari mos të maltretohet për një dokument bazik, kur institucionet kanë obligime që të njëjtat në mënyrë transparente t'i vendosim nëpër ueb faqet e tyre.

Prandaj, ne presim që të gjitha institucionet, ashtu siç u tha edhe në rekomandime, të jenë të përkushtuara dhe që në interes të qytetarit, por edhe që demonstrojnë standarde të larta të menaxhimit në këtë fushë që në një afat sa më të shkurtër të gjitha institucionet të raportojnë dhe në këtë fushë të arrihet progresi i nevojshëm dhe i domosdoshëm dhe për standardet e sjelljeve tona për interes të qytetarëve, por edhe për të demonstruar standardet në raport edhe me Raportin e Progresit. Ju faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit, zoti deputet!
Xhevahire Izmaqu, PDK.

XHEVAHIRE IZMAKU: Faleminderit, kryesues!

I nderuar ministër,

Të nderuar kolegë deputetë,

Grupi Parlamentar i Partisë Demokratike e ka analizuar Raportin për monitorimin e zbatimit të Ligjit për qasje në dokumentet publike, duke marrë pjesë paraprakisht në grupet punuese në komisionin përkatës dhe në të gjitha aktivitetet rreth këtij monitorimi.

Në bazë të vizitave në terren dhe analizave tjera nga dëgjimi publik, komunikimi me organizatat joqeveritare, por edhe shoqërinë civile, opinioni ynë lidhur me zbatueshmërinë e ligjit në fjalë inkurajon për një vazhdimësi të punës edhe më të angazhuar të gjitha institucioneve tona në këtë drejtim, sigurisht, edhe të ne vetë deputetëve në ushtrim të plotë të autoritetit në bazë të ligjit në fuqi.

Sipas konfirmimeve që kanë dhënë përfaqësuesit e institucioneve, kërkesat e qytetarëve për qasje në dokumentet publike janë të përmbushura në tërësi si dhe të gjitha dokumentet e këtyre institucioneve janë të publikuara në ueb faqet e tyre, me përjashtim të institucionit të Avokatit të Popullit. Mirëpo, ato kërkesa janë numerikisht të ulëta pasi që mungesa e formularëve për t'i plotësuar dhe mungesa e personave përgjegjës të përcaktuar që qytetarët mund t'ju drejtohen lidhur me qasjen në këto dokumente, ka penguar vazhdimisht zbatimin e ligjit.

Rekomandojmë që ministritë përgjegjëse duhet sa më parë t'i nxjerrin aktet e parapara nënligjore që ndihmojnë avancimin e zbatueshmërisë në këtë drejtim, ndërsa niveli lokal dhe agjencionet e pavarura e kanë obligim që aktet nënligjore dhe rregulloret e tyre t'ia përshtatin ligjit në fuqi.

Grupi Parlamentar i Partisë Demokratike e mbështet raportin me sugjerimet e theksuara. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit, zonja deputete!

Në emër të Grupit Parlamentar të “Vetëvendosjes”, deputetja Albana Gashi.

ALBANA GASHI: Faleminderit, kryesues!

Lëvizja “Vetëvendosje” ka shqyrtuar raportin për mbikëqyrjen e zbatimit të Ligjit për qasje në dokumentet publike dhe si të tillë e përkrahim në parim këtë raport. Ndonëse kjo lëvizje konsideron se ky raport duhet të ishte më gjithëpërfshirës, megjithatë përsëri të gjeturat e këtij raporti përbëjnë një shqetësim serioz lidhur me mosrealizimin e të drejtës për qasje në dokumentet publike dhe zyrtare.

Në këtë rast vlen të veçohet rasti skandaloz i Qeverisë së Kosovës, për ta mbajtur të fshehur kontratën me kompaninë “Bechtel - Enka” lidhur me autostradën Morinë – Merdar, kontratë kjo të cilën Lëvizja “Vetëvendosje” arriti ta servojë për publikun.

Shqetësim tjetër paraqet edhe mungesa e zyrtarëve adekuat për qasje në dokumentet publike, si në nivel lokal, ashtu edhe në atë qendror të pushtetit. Kurse, kjo mungesë, sidomos nxjerrja e akteve nënligjore lidhur me zbatimin e ligjit në fjalë, shkakton një kaos të përgjithshëm administrativ dhe pamundëson aksesin e qytetarëve të Kosovës në dokumentet publike.

Prandaj, Lëvizja përkrah dhe rekomandimet e këtij raporti, por krahas këtyre rekomandimeve kërkojmë edhe inkorporimin e instancave juridike për të ndërmarrë masa konkrete ndaj të gjithë atyre palëve që pengojnë qasjen në dokumentet publike. Këtu është fjala për moszbatimin e një ligji shumë të rëndësishëm për zhvillimin e demokracisë dhe transparencës e mosrespektimi i ligjit në çdo rast ndëshkohet dhe nuk tejkalohet vetëm me rekomandime. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit!

Për Grupin e Aleancës për Ardhmërinë e Kosovës, Teuta Haxhiu.

TEUTA HAXHIU: Faleminderit!

I nderuar kryesues,

Edhe Grupi Parlamentar i Aleancës për Ardhmërinë e Kosovës e përkrah raportin me rekomandime, sepse ky raport paraqet një gjendje reale të institucioneve lokale dhe qendrore. E unë në veçanti dua ta përmend rastin gjatë vizitës që kemi pasur në komunën e Gjakovës. Në këtë rast po e shfrytëzoj rastin ta falënderoj kryetarin e komunës së Gjakovës, i cili jo vetëm se ishte shumë transparent me anëtarët e Komisionit tonë, por bëri të mundur që të marrin pjesë edhe në dëgjimin publik që organizohet dy herë në vjet në komuna. Kjo ishte një transparencë që ne realisht nuk e kemi pritur, por jemi ndarë shumë të kënaqur, prandaj, ne e përkrahim raportin dhe të gjitha rekomandimet që janë paraqitur në të. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Jeton Svirca, për Aleancën Kosova e Re.

JETON SVIRCA: Faleminderit!

I nderuar kryesues,

I nderuar ministër,

Raporti i Komisionit për Arsim, Kulturë, Rini e Sport, edhe pse Komisioni ka marrë këtë vendim shumë kohë më parë, në monitorimin e zbatimit të Ligjit për qasje në dokumente publike, më 22 qershor 2011, si pjesë e obligimeve parlamentare për përmbushjen e vërejtjeve apo tejkalimit të sfidave të vëna re nga Raporti i Progresit për vitin 2010, duket se nuk i ka mjaftuar kohë për të mbyllur procesin monitorues.

Pavarësisht se raporti thekson se kërkesat e qytetarëve për qasje në dokumente publike janë përmbushur qind për qind, vetë numri i kërkesave të bëra dhe të shqyrtuara, janë dëshmi se thuaj asgjë nuk është në rregull në këtë fushë. Pasi që shumica e kërkesave të qytetarëve në 11 komunat e marra në konsiderim janë nga një apo nga dy, ku vetëm Kaçaniku ka kërkesa dyshifrore, 11 kërkesa të tilla, ndërsa Prishtina 2, Gjilani 6, Ferizaj 4 dhe të gjitha komunat tjera me nga dy kërkesa apo tri.

Pra, kjo është një provë për qytetarët që as mendojnë që është e mundshme që të sigurojnë qasje në dokumentet e tyre.

Kur jemi te ky problem është vetë komisioni që nga një detyrat apo fushëveprimet që i ka në mbikëqyrjen e mediave, nuk i ka kushtuar shumë rëndësi aq sa mediat që të kenë qasje në dokumentet zyrtare. Megjithëse ato në vazhdimësi kanë ankesa po thuaj se për të gjitha institucionet, pa përjashtim, nga gjyqësori deri te institucionet më të larta shtetërore, se informacionet mbahen të mbyllura deri tek ato më elementare, të cilat janë të detyruara institucionet që t'i publikojnë.

Por, Komisioni është kënaqur me opinionin se të gjitha institucionet e vëna në monitorim t'i bëjnë publike dokumentet e tyre në ueb faqe, gjë që thuaj nuk qëndron ashtu, pasi që shumica e shkresave dhe dokumenteve është e pamundur të vijë në dispozicion të publikut në sistemin digjital apo të internetit.

Komisioni është kënaqur me paraqitjen grafike të disa tabelave dhe paraqitje figurative, siç është rasti me kërkesat e qytetarëve duke zënë thuaj dy faqe të raportit, në mënyrë që raporti sikurse ai i Komisionit për Punë të Jashtme të duket voluminoz. E vetmja punë që duket se ja vlen është rekomandimi i parë të cilin Komisioni ka mundur ta nxjerrë edhe pa e nisur fare monitorimin duke konstatuar se institucionet e Republikës së Kosovës duhet ta caktojnë personin zyrtar përgjegjës për pranimin dhe shqyrtimin e kërkesave për qasjen në dokumente publike, ashtu siç parashihet në nenin 5.1 të ligjit në fjalë. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit, zoti deputet!

Diskutuesja e fundit është deputetja Rita Hajzeraj- Beqaj.

RITA HAJZERAJ – BEQAJ: Faleminderit, zoti nënkryetar!

Të nderuar deputetë,

I nderuar ministër,

Ligji për qasje në dokumente publike konsideroj që është ligji më i rëndësishëm në Republikën e Kosovës, i cili i vë në pah të vërtetat dhe të pavërtetat e tenderëve të shumtë të cilët po i keqpërdor Qeveria e Kosovës. Po ashtu është një prej ligjeve, i cili nuk zbatohet në Republikën tonë.

Raporti për mbikëqyrjen e zbatimit të Ligjit për qasje në dokumente publike nga ana e Komisionit për Arsim, Kulturë, Rini, sport, Administratë Publike, është i qëlluar dhe konsideroj se ky komision ka bërë një punë të mirë rreth monitorimit të Ligjit për qasje në dokumentet publike edhe pse mungojnë vërejtjet nga Raporti i Progresit, i cili ka jashtëzakonisht vërejtje serioze në lidhje me qasjet në dokumentet publike apo zyrtare.

Prandaj, e kërkoja fjalën që të ndërlihem me këtë raport, pra edhe unë të jap kontributin me qëllim që i njëjti raport të begatohet në të ardhmen nëse komisionet përkatëse e shohin të arsyeshme që ta shohim implementimin e këtij projektligji. E drejta e qasjes në dokumentet publike është e drejtë e garantuar me nenin 41 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës dhe se kjo e drejtë e shpreh shkallën e demokracisë së një vendi.

Po ashtu, kemi edhe nenin 10 të Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut, e cila e rregullon këtë çështje.

Konsideroj se ligji ka pasur mangësi si dhe ngecje në nxjerrjen e akteve juridike dhe udhëzimeve administrative, po prapëseprapë në këtë drejtim janë vërejtur disa të meta lidhur me mospërputhjen e ligjit dhe udhëzimeve administrative, çka do të thotë që janë kolizion me njëra-tjetrën.

Gjithashtu, është vërejtur mos mbajtja e regjistrave publik dhe mos krijimi i zyrave për trajtimin e kërkesave për qasjen në dokumentet zyrtare, ashtu siç është paraparë me ligj. Pra, shihet se edhe Avokati i Popullit ka qenë i penguar lidhur me hetimin e një ligji i cili është për zhurmën dhe se kjo do të ishte dëshmi e mirë për nivelin e zbatimit të këtij projektligji.

Qasja në dokumentet zyrtare si dhe mungesa e transparencës mbetet ndër problemet kryesore me të cilët ballafaqohen kryesisht gazetarët tanë, sepse gjatë punës së tyre sidomos kur kërkojnë informata lidhur me tenderët, atyre gati në të shumtën e rasteve nuk u ofrohen dokumente zyrtare dhe informacione të kërkuara.

Mirëpo, shihet se në zbatimin e këtij ligji akoma nuk është bërë miratim i legjislacionit përfundimtar, siç shprehet në rekomandimet përfundimtare të Komisionit për Arsim.

Në këtë drejtim, edhe Raporti i Progresit 2011 për Kosovën, nga Komisioni për Parlamentin dhe Këshillin Evropian, në faqen 41, flet për arsimin dhe problemet të cilat hasen në implementimin e këtij projektligji. Pra, e cila ministri nuk e respekton ligjin për qasje në dokumente zyrtare, është i njëjti fakt që ndodh në të gjitha ministrinë tona. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit, zonja deputete!

Nuk kemi më diskutues dhe nuk kemi as deputetë për të votuar, sepse në sallë janë 56 deputetë. Unë e mbyll këtë mbledhje në këtë moment dhe e vazhdojmë në orën 14:00.

Vazhdimi i seancës pas pauze

KRYETARI: Po fillojmë me pikën e 12-të, të 11-tën po e lëmë pasi s'e kemi kuorumin. Nëse e bëjmë kuorumin, votojmë për të gjitha pikat përnjëherë. Po e shqyrtojmë pikën e 12-të të rendit të ditës:

12. Shqyrtimi i Rekomandimit të Komisionit për Buxhet dhe Financa lidhur me kërkesën e Agjencisë Kosovare të Privatizimit për transfer të mjeteve në mes të programeve buxhetore

Komisioni për Buxhet dhe Financa ka shqyrtuar kërkesën për transfer të mjeteve në mes të programeve buxhetore dhe Kuvendit ia ka rekomanduar për miratim.

Përfaqësues të Qeverisë, nuk kemi.

Kryetarja e Komisionit për Buxhet dhe Financa, deputetja Safete Hadergjonaj, a është këtu?

Urdhëro, Safete, ta arsyetoni raportin me rekomandime.

SAFETE HADERGJONAJ: Faleminderit, zoti kryetar!

Të nderuar deputetë,

Agjencia Kosovare e Privatizimit ka kërkuar aprovimin e transeferit të mjeteve nga kategoria e investimeve kapitale, në kategorinë - Mallra dhe shërbime.

Transferi është kërkuar të bëhet nga programi i administratës qendrore - Investimet kapitale, çka do të thotë prej projektit - Riparimi i ndërtesës së Agjencionit Kosovar të Privatizimit dhe zyrave regjionale, në vlerë prej 30 mijë eurove dhe programit të zhvillimit të softuerëve për administrimin financiar të fondeve në vlerë 45 mijë euro.

Pra, shuma prej 75 mijë eurove është kërkuar të transferohet në kategorinë - Mallra dhe shërbime me qëllim të intensifikimit të procesit të likuidimit të ndërmarrjeve shoqërore dhe mbulimit të shpenzimeve për publikimin e listave të punëtorëve në shtypin ditor lokal dhe atë ndërkombëtar, sipas legjislacionit të cilën e ka në fuqi.

Në pajtim me nenin 30.4 të Ligjit numër 03/L-048 për menaxhimin e financave publike dhe përgjegjësitë, nëse udhëheqësi i organizatës buxhetore kërkon nga ministri që ta autorizojë transferin e një shume të barabartë me 25% apo më shumë të ndarjes së ndikuar negativisht, ministri mund ta autorizojë transferin e kësaj shume vetëm pas marrjes së miratimit me shkrim nga Kuvendi i Kosovës.

Aprovimi i këtij transferi i tejkalon pra kompetencat e ministrit të Financave, sepse shuma e kërkuar për transfer është 75 mijë euro nga kategoria ekonomike e investimeve

kapitale të programit të administratës qendrore dhe është e paraparë më 50% e ndarjes së ndikuar negativisht, atëherë Kuvendi sipas ligjit duhet të marrë vendim për aprovim apo mos aprovim të kësaj kërkesë.

Komisioni për Buxhet dhe Financa, në bazë të nenit 30.4 e Ligjit për menaxhimin e financave publike dhe përgjegjësi dhe nenit 69.5 të Rregullores së Kuvendit, në mbledhjen e mbajtur më 10.11.2011, shqyrtoi kërkesën numër 350, datë 13.9.2011 të Agjencisë Kosovare të Privatizimit për transfer të mjeteve në mes të programeve buxhetore dhe pas marrjes së sqarimeve nga ana e përfaqësuesve të Agjencionit Kosovar të Privatizimit, që ishin ftuar të jenë prezentë në mbledhjen e Komisionit dhe pas marrjes së sqarimeve se pse nuk janë realizuar projektet kapitale dhe pasi është dhënë arsyeshmëria se pse këto mjete duhen të transferohen në kategorinë mallra dhe shërbime, Komisioni ka rekomanduar që të miratohet kërkesa e Agjencisë Kosovare të Privatizimit, për transferin e mjeteve nga kategoria ekonomike investime kapitale, programi i administratës qendrore kodi 229 nga projektet riparimi i ndërtesës së Agjencionit të Privatizimit të Kosovës dhe zyrave regjionale, kodi i projektit 12-429, në vlerë prej 30 mijë eurove dhe zhvillimi i softuerëve për administrimin financiar të fondeve në mirëbesim, kodi i projektit 11-194 në vlerë prej 45 mijë eurove në kategorinë mallra dhe shërbime, programi i likuidimit, kodi 227 në vlerë prej 75 mijë eurove.

Komisioni për Buxhet dhe Financa, ka konstatuar se është i arsyeshëm një transfer i tillë i mjeteve dhe kërkon nga deputetët e Kuvendit që ta miratojnë kërkesën e Agjencionit të Privatizimit të Kosovës. Faleminderit!

KRYETARI: Faleminderit, deputete!

Në emër të Grupit Parlamentar të PDK-së, fjalën e ka kërkuar deputetja Hasime Krasniqi.

HASIME KRASNIQI: Faleminderit, zoti kryetar!

Përshëndetje për të gjithë kolegët!

Grupi Parlamentar i Partisë Demokratike e ka shqyrtuar dhe analizuar kërkesën për transfer të mjeteve në mes të programeve buxhetore të AKP-së dhe ka vendosur që ta mbështetë këtë kërkesë duke pasur parasysh rëndësinë që ka i tërë procesi i likuidimit, në mënyrë që të mundësohet mbarëvajtja e punëve në këtë proces. Po ashtu, të mundësohet publikimi i listave të punëtorëve për 20%, në shtypin vendor dhe ndërkombëtar, sipas ligjeve në fuqi.

Grupi Parlamentar i Partisë Demokratike e mbështet rekomandimin e Komisionit për Buxhet dhe Financa. Faleminderit!

KRYETARI: Faleminderit!

Në emër të LDK-së, deputeti Naser Osmani e ka fjalën.

NASER OSMANI: Faleminderit, kryetar!

Ne deputetët e LDK-së edhe në Komisionin për Buxhet dhe Financa e kemi dhënë votën “për” në kërkesën e këtij agjencioni, me arsyetimin që e dha kryetarja e Komisionit për

Buxhet dhe Financa dhe konsiderojmë që një bartje e mjeteve brenda një organizate buxhetore prej pozicionit të investimeve kapitale në kategorinë e mallrave dhe shërbimeve, ka qenë e arsyeshme dhe ne e përkrahim. Faleminderit!

KRYETARI: Faleminderit!

Në emër të Grupit të “Vetëvendosjes”, deputeti Visar Ymeri, me kartelën e Albana Fetoshit.

VISAR YMERI: Faleminderit, kryetar!

Edhe Grupi Parlamentar i lëvizjes “Vetëvendosje” do ta përkrahë këtë transfer të fondeve përbrenda buxhetit të AKP-së, në këtë pozicion për mallra dhe shërbime edhe e përkrahim këtë vetëm për shkak se ka të bëjë me listat e punëtorëve. Përndryshe, kjo mënyrë e mos planifikimit fillestar të buxhetit dhe pastaj të këtyre ndryshimeve, unë konsideroj që do të duhej të bëheshin në mënyrë pak më serioze që në fillim dhe pastaj në vazhdim. Mirëpo, me këtë rast, me qenë se kemi të bëjmë për këtë çështje specifike, atëherë e përkrahim këtë kërkesë.

KRYETARI: Faleminderit, deputet!

Në emër të AAK-së, deputeti Xhevdet Neziraj.

XHEVDET NEZIRAJ: Faleminderit!

I nderuar zoti kryetar,

Edhe Grupi Kuvendor i Aleancës për Ardhmërinë e Kosovës e përkrah rekomandimin e Komisionit për Buxhet dhe Financa dhe arsyeja kryesore për Aleancën për Ardhmërinë e Kosovës është të bëhet transferi dhe që sa më shpejtë 20% të alokohet tek punëtorët që aq shumë po e presin.

Ndërsa, Grupi Parlamentar i Aleancës për Ardhmërinë e Kosovës, pra, ka votuar edhe në Komision për këtë alokim të këtyre mjeteve dhe kjo është bërë për arsye se s’ka pasur mundësi që të bëhet rishikimi i buxhetit në këtë vit. Ju faleminderit!

KRYETARI: Faleminderit!

Në emër të Grupit Koalicionit për Kosova e Re, deputetja Myzejane Selmani e ka fjalën.

MYZEJANE SELMANI: Faleminderit, kryetar!

Koalicioni për Kosovë të Re, përkrah rekomandimet e Komisionit për Buxhet dhe Financa lidhur me kërkesën e Agjencionit Kosovar të Privatizimit, për transfer të mjeteve në mes të programeve buxhetore, për arsye se janë nevojat të cilat duhen të plotësohen për punëtorët dhe njëkohësisht do të japin votën e vet gjithë deputetët e koalicionit në përgjithësi, të punëtorëve që të hiqet ky 20% tash edhe një herë e përgjithmonë. Faleminderit!

KRYETARI: Faleminderit!

Në emër të Grupit Parlamentar të SLS-së, nuk ka.

Në emër të Grupit Parlamentar “6+”, nuk ka.

Deputetë tjerë nuk janë lajmëruar për diskutim.

Kalojmë në pikën e trembëdhjetë:

13. Shqyrtimi i Rekomandimit të Komisionit për Buxhet dhe Financa lidhur me kërkesën e Ministrisë së Mjedisit dhe të Planifikimit Hapësinor për transfer të mjeteve në mes programeve buxhetore

Komisioni për Buxhet dhe Financa ka shqyrtuar kërkesën për transfer të mjeteve në mes programeve buxhetore dhe Kuvendit ia ka rekomanduar për miratim.

Qeverinë nuk e kemi këtu.

Në emër të komisionit, fjalën e ka kryetarja e komisionit, deputetja Safete Hadergjona.

SAFETE HADERGJONAJ: Faleminderit, zoti kryetar!

Komisioni për Buxhet dhe Financa, po ashtu, me datën 11.10.2011, ka shqyrtuar kërkesën e Ministrisë së Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor, ku kanë qenë prezentë edhe përfaqësuesit nga Ministria e Mjedisit dhe e Planifikimit Hapësinor, dhe pas sqarimeve të cilat janë dhënë rreth këtij projekti, ku duhet të bëhet bartja e mjeteve, Komisioni për Buxhet dhe Financa, ka miratuar kërkesën e Ministrisë së Mjedisit, ku ka rekomanduar që nga programi i Agjencionit për Mbrojtjen e Mjedisit, kodi 436, kategoria ekonomike – investime kapitale, projekti i binjakëzimit të Agjencionit për Mbrojtjen e Mjedisit me agjencionet mjedisore të Austrisë dhe Finlandës, kodi i projektit, 12 mijë e 709 euro në vlerë prej 50.000 eurove, në programin e Agjencionit për Mbrojtjen e Mjedisit, kodi 436 në kategorinë ekonomike, mallra dhe shërbime, në vlerë prej 50.000 eurove.

Edhe ky transfer duhet të miratohet nga Kuvendi, sepse kalon 25% e ndikuar negativisht në program dhe Ministria, përfaqësuesit e Ministrisë në Komision i kanë dhënë arsyetimet e tyre, sepse në momentin e nënshkrimit të kontratës me Komisionin Evropian, përkatësisht me projektin e IPAS, nuk kanë qenë të detализuar të gjitha çështjet që kanë të bëjnë me bashkëfinancimin e projektit të caktuar, kështu që në momentin kur është nënshkruar kontrata dhe janë detализuar të gjitha të dhënat, atëherë në këtë aneks që është nënshkruar, shuma e mjeteve të financuara nga Buxheti i Republikës së Kosovës, është e paraparë të shpenzohet për shpenzimet operative të Zyrës së Projektit në Kosovë, e cila është themeluar në Ministrinë e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor.

Për këtë arsye Komisioni për Buxhet dhe Financa, e ka miratuar këtë kërkesë me arsyeshmërinë e cila është dhënë nga Ministria e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor. Rekomandohen që edhe deputetët ta miratojnë.

KRYETARI: Ju faleminderit!

Në emër të Grupit Parlamentar të Partisë Demokratike, deputetja Hasime Krasniqi e ka fjalën.

HASIME KRASNIQI: Edhe Grupi Parlamentar i Partisë Demokratike ka shqyrtuar kërkesën e Ministrisë të Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor për transferimin e mjeteve në mes të programeve buxhetore të Agjencionit për Mbrojtjen e Mjedisit, me qëllim të mbulimit të shpenzimeve operative të Zyrës në Kosovë, e cila është në vlerë prej 10% të projektit në tërësi si bashkëfinancim me IPO-n. Ju faleminderit!

KRYETARI: Ju faleminderit!

Në emër të Grupit Parlamentar të Lidhjes Demokratike të Kosovës, Naser Osmani e ka fjalën.

NASER OSMANI: Ju faleminderit, kryetar, edhe një herë!

E konsideroj se kjo çështje është ende më e thjeshtë se atë që pak më herët e diskutuam. Fjala është për mjete të cilat janë të lejuara me buxhet, mirëpo që nuk janë paraparë në mallra dhe shërbime, por kanë qenë të parapara në investime kapitale. Por, natyra e këtij projekti është dashur që pagesa të bëhet nga kodet e mallrave dhe të shërbimeve dhe jo kështu qysh është, domethënë më tepër ka të bëjë me një përmirësim të një gabimi apo një lëshimi që ka ndodhur gjatë hartimit të buxhetit dhe në mungesën e rishikimit të buxhetit që këto duhet të rregullohen, konsideroj se kjo është thjesht më tepër çështje teknike dhe duhet aprovuar. Ju faleminderit!

KRYETARI: Ju faleminderit, deputet!

Në emër të “Vetëvendosjes”, kush e do fjalën?

Deputeti Liburn Aliu e ka fjalën.

LIBURN ALIU: Edhe Grupi Parlamentar “Vetëvendosje” do ta përkrahë rekomandimin e Komisionit për Buxhet dhe Financa lidhur me kërkesën e Ministrisë së Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor për transfer të mjeteve në mes programeve buxhetore. Konsiderojmë edhe ne që ky ishte një gabim dhe duhet përmirësuar, kështu që do ta votojmë.

KRYETARI: Ju faleminderit!

Në emër të Aleancës, deputeti Xhevdet Neziraj.

XHEVDET NEZIRAJ: Ju faleminderit, zoti kryetar!

Pas sqarimeve që i dha kryetarja e Komisionit, por edhe zoti nënkryetar Naser Osmani, edhe Grupi i Aleancës do ta mbështetë kalimin e këtyre mjeteve në një kod tjetër, me qëllim të financimit të këtij projekti. Ju faleminderit!

KRYETARI: Ju faleminderit, deputet!

Në emër të Grupit Parlamentar Koalicioni për Kosovë të Re, deputetja Myzejene Selmani e ka fjalën.

MYZEJENE SELMANI: Ju faleminderit, kryetar!

Koalicioni për Kosovë të Re e përkrah rekomandimin e Komisionit për Buxhet dhe Financa. lidhur me sqarimet që i dha për kërkesën e Ministrisë së Mjedisit dhe

Planifikimit Hapësinor për transfer të mjeteve në mes të programeve buxhetore. Ju faleminderit!

KRYETARI: Ju faleminderit! Në emër të SLS, nuk ka.

Në emër të Grupit Parlamentar “6+”, nuk ka.

Një deputet e kemi të lajmëruar.

Fjalën e ka deputeti Armend Zemaj.

ARMEND ZEMAJ: Ju faleminderit, kryetar!

Pasi që nuk e kemi Qeverinë të pranishme, sepse për kërkesat e tilla unë mendoj që është shumë serioze dhe e domosdoshme që të jetë personi që e ka bërë kërkesën, mos ta shndërrojë Kuvendin vetëm një instrument të Qeverisë apo për rregullimin, tejkalimin e problemeve që kanë brenda një fushe të caktuar, sepse edhe shihen, e dha arsyetimin edhe Komisioni, kjo është çështje teknike që ka mund të zgjidhet edhe me rishikimin buxhetor që është dashur të bëhet, por edhe me planifikimin në kornizën afatmesme të shpenzimeve.

Prandaj, unë mendoj se niveli i përgjegjësisë të ministrave të caktuar ka rënë, sepse ashtu nuk kanë nivel të përgjegjësisë, sepse nuk e kanë votën popullore. I vetmi nivel i përgjegjësisë është ndaj shefit të Qeverisë dhe kjo tregon që Kuvendi po shndërrohet në instrument edhe komisionet po shndërrohen në instrument të panevojshëm, duke marrë parasysh trajtimin e kërkesave të tilla. Dhe, unë mendoj që ju si kryetar i Kuvendit, duhet t’i parashtroni vërejtje serioze apo sugjerim, sepse mund të ketë kërkesa të radhës që janë shumë më shumë delikate se sa kjo që e ashtuquajtura teknike apo tejkalim të mjeteve prej një kodi në kod, por kur të vijë raporti i shpenzimeve edhe nëntëmujorit, po mendoj edhe përfundimit vjetor, atëherë do t’i shohim edhe lëvizjet tjera.

Prandaj, çështjet që duhet të rregullohen me ligj, është mirë që i ka kryer Komisioni, por unë mendoj se përgjegjësia e ministrave të caktuar për parashtrimin e kërkesave të veta, po shihet dhe nga kjo që sot u paraqit para neve. Ju faleminderit!

KRYETARI: Ju faleminderit!

Të lajmëruar të tjerë nuk ka. Në sallë janë prezent 67 deputetë, kështu që mund të hyjmë në procedurën e votimit.

I kemi tri pika për t’i votuar. Për votim kemi pikën e 11-të:

- Miratimi i Raportit të Komisionit për Arsim, Kulturë, Rini, Sport, Administratë Publike, Qeverisje Lokale dhe Media për mbikëqyrjen e zbatimit të Ligjit për qasje në dokumentet zyrtare.

Ju debatin e keni zhvilluar për këtë para dite, do të thotë, para orës 12,00. tash kemi votimin e tij.

Lus deputetët dhe regjinë të përgatiten për votim dhe votojmë tash.

Konstatohet se me 65 vota “për”, asnjë “kundër” asnjë abstenim, Kuvendi miratoi Raportin me rekomandime të Komisionit për Arsim, Kulturë, Rini, Sport, Administratë Publike, Qeverisje Lokale dhe Media lidhur me zbatimin e Ligjit për qasje në dokumentet publike.

Votojmë tash pikën e 12-të të rendit të ditës:

- Shqyrtimi i Rekomandimit të Komisionit për Buxhet dhe Financa lidhur me kërkesën e Agjencisë Kosovare të Privatizimit për transfer të mjeteve në mes të programeve buxhetore.

Debati është kryer. Lus regjinë dhe deputetët, të përgatiten për votim.

Votojmë, tash!

Konstatohet se me 66 vota “për”, 1 “kundër” asnjë abstenim, Kuvendi miratoi kërkesën e Agjencisë Kosovare të Privatizimit për transefer të mjeteve në mes të programeve buxhetore.

Votojmë pikën e 13-të:

- Rekomandimi i Komisionit për Buxhet dhe Financa lidhur me kërkesën e Ministrisë së Mjedisit dhe të Planifikimit Hapësinor për transfer të mjeteve në mes të programeve buxhetore.

Debatin e kryem më parë. Lus deputetët dhe regjinë të përgatiten për votim. Votojmë, tash!

Në sallë gjithnjë janë 67 deputetë.

Konstatohet se me 65 vota “për”, 2 “kundër”, asnjë abstenim, Kuvendi miratoi kërkesën e Ministrisë për Mjedis dhe Planifikim Hapësinor për transfer të mjeteve në mes programeve buxhetore.

KRYETARI: Në radhë kemi pikën e 14 të rendit të ditës:

14. Shqyrtimi i propozimit të Qeverisë së Republikës së Kosovës për emërimin e anëtarëve në Bordin e Komisionit të Pavarur për Miniera dhe Minerale

Fjalën e ka kërkuar deputeti Adem Grabovci, meqenëse debatin e kemi kryer.

ADEM GRABOVCI: Faleminderit, kryetar!

Në emër të Grupit Parlamentar të Partisë Demokratike, kërkoj që votimi për këta kandidatë, për këtë bord të shtyhet për ndonjë seancë tjetër.

KRYETARI: A janë të pajtueshëm kryetarët e grupeve tjera parlamentare?

Fjalën e ka deputeti Ismet Beqiri.

ISMET BEQIRI: Zoti kryetar, ne edhe herën e kaluar kemi thënë se pajtohemi që sot këta të mos votohen, por mos të vijmë herën tjetër fare, por që sot të mos votohen, pajtohemi. Faleminderit!

KRYETARI: Fjalën e ka Visar Ymeri.

VISAR YMERI: Faleminderit, kryetar!

Lëvizja “Vetëvendosje” konsideron që meqenëse kjo listë është refuzuar herën e parë dhe po refuzohet tash herën e dytë, nuk ka kuptim të vijë tash herën e tretë e njëjta listë, për shkak se prapë do ta kemi reagimin e njëjtë të deputetëve. Siç po shihet këtë herë, nuk do të ketë ndryshim të mendimit të deputetëve, siç ka ndodhur disa herë, kështu që kjo listë është dashur nëse vjen herën e ardhshme, të vijë të paktën me ata 5 emra, të cilët kanë qenë në Qeveri dhe të votojnë deputetët, ta kenë një zgjedhje më të madhe. Faleminderit!

KRYETARI: Jo, unë e kam mirëkuptimin për këtë, Visar, por një çështje është, unë edhe Kryesia nuk kemi të drejtë ta kthejmë. Të drejtën për ta kthyer këtë propozim e ka Kuvendi, prandaj është mirë që këtë ta kemi të qartë. Kuvendi është ai që e kthen, ndoshta është mirë që ne të bisedojmë, vërtet a duam të marrin pjesë në votim ose a të votojmë për t’ia kthyer Qeverisë dhe për të na rikthyer përsëri? Ky vendim do të jetë i Kuvendit, jo i ynë, pse nuk kemi mund ta votojmë në mbledhjen e kaluar. Dhe, unë mendoj që çështjet që vijnë në Kuvend, ne duhet t’i dimë paraprakisht se cila është procedura e kthimit.

Në emër të AAK-së, a e do dikush fjalën?

Fjalën e ka Burim Ramadani.

BURIM RAMADANI: Faleminderit, kryetar!

Normalisht që jemi për ta shtyrë edhe mundet edhe Qeveria ta tërheq propozimin që e ka prurë në Kuvend. Kërkesa jonë ka qenë edhe herën e kaluar që mos të hyjë në votim, tash është mirë që edhe koalicioni e ka të njëjtën kërkesë. Kërkesa jonë e tashme është që Qeveria ta tërheq, mos të futet në procedurat tjera dhe besoj që në seancën e ardhshme edhe koalicioni ka për ta kërkuar të njëjtën që Qeveria ta tërheq. Faleminderit!

KRYETARI: Myzejene Selmani e ka fjalën.

MYZEJENE SELMANI: Faleminderit, kryetar!

Edhe Koalicioni për Kosovë të Re e përkrah që sot për Komisionin për Miniera dhe Minerale të mos votohen këta dy anëtarë, por në një seancë tjetër.

KRYETARI: Fjalën e ka deputeti Sasha Millosavljeviq.

SAŠA MILOSAVLJEVIČ: Hvala, gospodine predsedniče!

I Parlamentarna grupa Samostalne liberalne stranke smatra da danas ne treba da se održi to glasanje i smatramo da multi etničnost nije uključena u ovom bordu, da manjinske zajednice nemaju svog predstavnika u ovom borda i da bi to trebalo da se razmotri i da posle toga dođe na glasanje u Skupštini. Hvala!

KRYETARI: Në emër të Grupit Parlamentar „6+” deputeti Albert Kinolli e ka fjalën.

ALBERT KINOLLI: Faleminderit, i nderuari kryetar!

Edhe Grupi Parlamentar “6+” ndan mendimin e njëjtë që të mos votohet në këtë seancë, por në seancën e radhës. Faleminderit!

KRYETARI: Para se të kalojmë në pikën e 15-të, unë jam i obliguar që t’ju njoftoj për një çështje tjetër, që pak a shumë lidhet me këtë punën e votimeve që i kemi në Kuvend. Ne duhet ta dimë si Kuvend, se Bordi i Pavarur për Media ose Komisioni i Pavarur për Media nuk mund të funksionojë për shkak të procedurave jo të ndjekura sipas ligjit dhe kanë mbetur 3 anëtarë pa u votuar. Në fakt, 4 anëtarë, i 4-ti është gati që 4 vjet, që duhet të jetë i Kuvendit dhe në këtë rast, Komisioni i Pavarur për Media nuk mund të ushtrojë funksionin e vet. Tash, u kalon mandati edhe 2 apo 3 anëtarëve të Bordit për Radio-Televizionin e Kosovës dhe, realisht, edhe këtu është një defekt, se çështja e atij bordit të Radio -Televizionit është çështje e Komisionit të Pavarur të Mediave. Prandaj, kemi këto çështje që ne jemi duke bllokuar funksionim e këtyre bordeve.

Unë ju kisha lutur që edhe Qeveria, kur të në vijmë nga Qeveria, të jenë, të respektohet ligji dhe kualitetet e njerëzve që adresohen për të qenë në këto borde ose komisione, të jenë në përputhshmëri me ligjin, siç e kërkon ligji dhe njëkohësisht do të duhej komisioni, ose duhet ta presim miratimin e Ligjit për Komisionin e Pavarur të Mediave, në mënyrë që pastaj edhe komisioni ... në Kuvend, të jetë kështu siç janë komisionet, të gjitha komisionet dhe jo në komisione me bazë partiake, se përndryshe ne si Kuvend po bëhemi pengesë për funksionimin e bordeve të caktuara.

Prandaj, kërkesa ime është që edhe atëherë kur janë në përgjegjësinë tonë, edhe atëherë kur është përgjegjësi e Qeverisë, kandidatët që ofrohen për t’i votuar Kuvendi dhe për të marrë përgjegjësinë Kuvendi, së paku le të jenë në përputhje me ligjet që i kemi miratuar vetë. Nëse një ligj nuk na bie tamam, është më mirë ta ndryshojmë ligjin dhe të veprojmë sipas ligjit, por ne nuk mund të veprojmë në kundërshtim me ligjet që i kemi në fuqi.

Do të jetë në dijeninë tuaj, do të thotë këto janë çështje që ne nganjëherë po bëhemi pengesë ose njerëzit që po ngarkohen të marrin detyra dhe përgjegjësi, nuk po i respektojnë ligjet dhe pastaj neve po na obligojnë që mos t’i respektojmë rekomandimet që nuk janë në përputhje me ligjet.

Për pikën e 14-të, shtyhet votimi. A jeni për t’u shtyrë, pastaj për të marrë një vendim? Kush është “për”? Mirë, faleminderit! A ka “kundër”? Nuk ka. Abstenim? Nuk ka.

Realisht, duhet një konsultim, por megjithatë vendimi për refuzim duhet të jetë i komisionit, që pastaj Qeveria të fillojë procedurën e re të...

(Ndërhyrje)

E kryem, ju lutem, mos ta komentojmë këtë çështje.

15. Propozimi i Grupit Parlamentar të LDK-së për zëvendësimin e anëtarit të Komisionit për të Drejtat e Njeriut, Barazi Gjinore, Persona të Pagjetur dhe Peticione

Grupi Parlamentar i Lidhjes Demokratike të Kosovës ka propozuar zëvendësimin e anëtarit të Komisionit për të Drejtat e Njeriut, Barazi Gjinore, Persona të Pagjetur dhe Peticione dhe në vend të deputetit Ismet Beqiri, ka propozuar deputeten Kimete Bytyçi.

Kërkoj nga deputetët që me ngritje dore të deklarojnë për propozimin e Grupit Parlamentar të LDK-së.

Kush është “për”? Faleminderit!

Edhe një çështje tjetër që mendoj se ndoshta ia vlen të njoftohemi, është çështja që Ligji për deputetët, i miratuar në Kuvend, parasheh sanksione për ata që nuk marrin pjesë në seanca dhe jo vetëm për pjesën e mëdijëve, por edhe në bazë të ardhurave, pra, në pagë. Prandaj, është mirë ta lexoni dhe ta keni parasysh, nëse administrata i kryen detyrat dhe obligimet e veta, ta dini që është në përputhje me ligjin.

Mirupafshim në seancën e radhës!

Përgatiti:

Njësia e Transkripteve e Kuvendit të Kosovës